

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XV i botimit, nr. 164, Qershor 2017
Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

DUKAGJINI - NDERI I KOMBIT JASHIË OBORRIT TË POLITIKËS!

TURP - TURP - TURP - VAJ - VAJ - VAJ!!

Nga Prelë Milani

Kur u ula në tryezë e mora penën në dorë më doli vetja qefti, pasi më dukej se po përsërisja të njëjtin refren shumë vjeçare, të cilin askush nuk ja vuri veshin, ndaj penda mu bë e rënde sa një mal. I gjendur përpara dilemës, ta ngre apo mos ta ngre, të b'za apo të heshte, zëri i ndërgjegjes më tha: - Lufto me armen tënde të vetme që ke për hise. Thirr sa të mundesh o tellall i vetmuar. Thirr sa të oshinë malet e zgjohen mendjet e përgjumura. Thirr e thuaj se Dukagjinin që po pushkatoni politikisht nuk mund të vdesë pa gojë.

VËRSHIMET E NJË PYLLTARI

- ME RASTIN E 60 VJETORIT TË LINDJES
TË INXHINIER GJON FIERZA -



Shoqata Atdhetare "Dukagjini,, sjell Malsorët e Rugovës në Bibliotekën "Marin Barleti", në Shkodër

Në fund të muajit maj në Bibliotekën e Shkodrës "Marin Barleti" dhe nën kujdesin e Shoqatës Atdhetare "Dukagjini" u organizua promovimi i dy veprave historike të autorit nga Rugova z. Fazli Muriq; "Koshutani heroik i Rugovës Kreshnike" dhe "Rugova kreshnike dhe e kaluara e saj historike". Një projekt i nisur që në janar pas një bashkëpunimi me mikun tonë të përbashkët Ali Daci.

Pata nderit të mbaj fjalën e hapjes dhe në mendimin tim modest të vlerësoj autorin dhe vlerat që mbartin këto vepra, rëndësinë që kanë për historinë, shpalsjen e vlerave heroike të figurës së pavdekshme të dr. Ibrahim Rugova..

GENTIANA LUTEA (Bari i zemrës)

E njohin si bar zemre, sanëz, kërrsanëxë, sancë, ksane, raven, lincurë - por emrin e ka Gentiana. Bëhet fjalë për një barishte të hidhur që vjen nga bima e verdhë me emrin botanik Gentiana lutea. Vendlindja e kësaj bime është në Evropën Jugore. Ajo gjendet në malet shtatlartë të Shqipërisë dhe në shpate që ngrihen mbi 1000 metra lartësi.

ESTË EMADHE NË GJAKOVË

PËRKUJTOHEN ME MADHËSHTI DITA E
ÇLIRIMIT TË GJAKOVËS DHE 80-VJETORI I
LINDJES,
LEGJENDË E KËNGËS POPULLORE
SHQIPTARE, ISMET PEJA

Në Pallatin e Kulturës "Asim Vokshi" në Gjakovë, në pjesëmarrje të jashtëzakonshme të qytetarëve gjakovarë, por dhe të personaliteteve të shquara të artit dhe kulturës mbarëshqiptare, morën pjesë shumë yje në këtë skenë, ku u zhvillua ceremonia përkujtimore kushtuar Ditës së Çlirimit të Gjakovës, si dhe 80-vjetorit të lindjes dhe 63-vjetorit të karrierës ...

Vllaznia në futboll për femra kampione për herë të katërt radhazi

Vllaznia e Shkodrës është kampione e Shqipërisë në futboll për femra për herë të katërt radhazi. Një sukses ky padyshim i madh për klubin Vllaznia

DUKAGJINI - NDERI I KOMBIT JASHIË OBORRIT TË POLITIKËS!

TURP - TURP - TURP - VAJ - VAJ - VAJ!!



Nga Prelë Milani

Kur u ula në tryezë e mora penën në dorë më doli vetja qefti, pasi më dukej se po përsërisja të njëjtin refren shumë vjeçare, të cilin askush nuk ja vuri veshin, ndaj penda mu bë e rënde sa një mal. I gjendur përpara

dilemës, ta ngre apo mos ta ngre, të b'za apo të heshte, zëri i ndërjegjes më tha: - Lufto me armen tënde të vetme që ke për hise. Thirr sa të mundesh o tellall i vetmuar. Thirr sa të oshtinë malet e zgjohen mendjet e përgjumura. Thirr e thuaj se Dukagjinin që po pushkatoni politikisht nuk mund të vdesë pa gojë.

E shkreta pena ime sot qanë duke derdhë lot zemërimi, jo se mbetëm pa bukë, por për Dukagjinin e mbetur jetim i pa përfaqësuar për 20 vjet në vendimarrje. Pena ime nuk qanë për një prapnice deputeti që mund të bëjë mrekullia, por për diskriminim dhe dinjitetin e përhumur të një krahine faqendritur nder shekuj, të pa as një njollë në histori.

Pena ime qanë për intelektualët e sotëm memec e miop të Dukagjinit, të cilët duhen lëçitur nga bashkësia e tyre dhe veshur me kotulla grash deri sa pranojnë të rrinë si sharov të rrahur nga "zotat" e politikës. Politika shqiptare duhet kallëzuar penalisht për diskriminim politik 27 vjeçar ndaj një krahine martire të pa shkelur kurrë veç opingës me çorape të leshit, të çakçirëve të bardhëve të maleve. Politika shqiptare duhet kallëzuar penalisht për diskriminim politik ndaj një bashkësie me mbi 25 mijë votues të pa përfaqësuar të shpërngulur prej halleve, kryesisht në Shkodër, por edhe në Malësi të Madhe, në Lezhë, në Laç, në Tiranë, në Durrës e në të tjera hapësira shqiptare. Politika shqiptare duhet kallëzuar penalisht për diskriminim politik të një krahine që i ka dhuruar kombit lulet më të begata të diturisë, të artit, të kulturës dhe të sportit, ndërsa bijtë dhe nipat e tyre politika e ndyrë i përbuz si primitat të ultë që duhet të merren në kujdestari nga kolltukofag bythë kthyes nga do që frynë era.

Politika shqiptare e majtë dhe e djathtë historikisht armike por edhe ndonjë herë të dashuruar në mënyre skandaloze ndaj bashkësisë Dukagjinase tash 20 vite, ka shkelur nenin 18. Pika 2 të Kushtetutës së RSH, sipas të cilit "Askush nuk mund të diskriminohet pa drejtësi për shkaqe të tilla si gjinia, raca, etnia, feja, bindjet politike fetare, gjendja ekonomike arsimit ose përkatësia prindërore". Çfarë emri përveç fjalës Diskriminim munde të ketë privimi nga pjesëmarrja në çështjet publike e drejta për tu zgjedhur i një treve liridashëset, për të cilën flet historia, i një treve me identitet, të pikasur kul-

turore, etnografik, gjeografik dhe burime njerëzore dhe intelektuale shumë vitale.

Politika djallëzore e të dy kampeve sunduese, bashkësinë dukagjinase e Dukagjinin e ka paragykuar dhe vlerësuar si kope të bindur elektorale që ndillet e gënjejhet me një grusht kripe duke shkuar pas trokës së ogiçëve të emëruar na çobanët politikës. Fatkeqësisht kjo bashkësi ka renë në ketë batak imoral, është zhytur deri në gryke në ketë llucë të pistë dhe aty gjendet duke u përpëlitur pa as një rrugë dalje. Dihet sa herezi është për një militant t'i kundërvihesh nenës parti, dhe sa pamundur është për një tifoz të sëmure të braktise skuadrën e zemrës qoftë edhe kur ajo e tradhton dhe trukon rezultatet. Dihet se interesaxhitë shkojnë pas partive si mizat në hale, por edhe për bukën e gojës shumë të tjerë janë të detyruar të qëndrojnë kokë ulur e gojë kyçur. Jo more, jo o vëllezër këta nuk janë shumica. Shumica e shëndoshtë e bashkësisë dukagjinase dhe shumica e shëndoshtë e shqiptarëve jam i bindur e duan më shumë Dukagjinin dhe Shqipërinë se partitë. Partitë janë pasuri e madhe, por kur nuk mund të peshojnë në kandarë sa atdheu.

Kur partitë tona të dashura i bien ndesh interesave të një bashkësie, apo shumicës së shqiptarëve duhen ndëshkuar me votë.

Ju miq të nderuar majtist dukagjinase (socialist, rilindës e leseist) me thoni kush ju përfaqëson në listat shumë emërore të së majtës?! Ju miq të nderuar majtist dukagjinase (socialist, rilindës e leseist) më thoni mos valle kanë vdekur burrat e gratë, djemtë dhe vajzat e dukagjinit (mësues, profesor doktor, jurist ekonomist, me të rijnë me mastra që kane studiuar brenda dhe jashtë vendit), që nuk u gjend një i vetëm t'u përfaqësojë ju në brigadën për "Shqipërinë që duam"

-Mua ndokush mund e më quaj rebel i pandreqshëm, ani punë e madhe! Por desha të pyes miqtë mi të vjetër "heretikët" të 91-it, Martin Gjon Gështenjën. Sokol Kodrën, Prekë Doçin. Prele Shytanin e të tjerë, që kemi udhëtuar në këmbë përgjatë Gurit të Kuq për hapjen e fushatës elektorale të PS-së në Shkodër. Hallall 12 orë udhëtimi, por Rrugëve të Qytetit dhe te Kinema Republika duhej pasur kujdes, se mos haje ndonjë gurë kokës nga turmat fanatike. Besoj se a ju kujtohet mirë kur mercenarët e verbër të pushtetit të atëhershëm, me qershor 1995 na zunë rrugën me lisa të prere e na qëlluan me armë vetëm se po shkonim në Shosh me deputete armiq të opozitës. Na zunë rrugën jo për të vra, por për të na kthyer pas e të poshtëruar, por nuk ja dolën. Përsëri dua të pyes shokët e mi të përvojatur të atyre viteve të errëta, më thoni kush ju përfaqëson në listat shumë emërore të së majtës?! A meritojnë të

mos përfillen sakrificat tuaja dhe qindra të majtëve të tjerë dukagjinase deri në atë shkallë sa të votoni me detyrim përcaktim për anonimat të importuar me urdhër nga lart, që as në lagjen "Mark Lula" nuk kane shkuar kurrë.

Ju miq të nderuar djathtistë dukagjinase (demokrat, republikan e demokristian) më thoni mos valle kanë vdekur burrat e gratë, djemtë dhe vajzat e dukagjinit që nuk u gjend një i vetëm për t'u përfaqësuar ju në koalicionin e madh të "Republikës së Re". Më dashamirësi desha të pyes Dede Token, Ndoc Ashtën, Kole Tonaj, Pal Rupën, Dedë Prendaj e të tjerë: Ju demokrat të orëve të para të nëntëdhjetës, që formuat Seksioni e Pare të PD-së, më pare në Dukagjin se sa në Shkodër (me ju vërtetë kam pasur bindje e qëndrime të kundërta), a meritojnë të mos përfillen sakrificat tuaja dhe qindra demokratëve të tjerë dukagjinase, që i keni dhënë PD-së tonelata votash deri në atë shkallë sa të votoni me detyrim përcaktim për emra të importuar me urdhër nga lartë, të cilët nuk e dinin se nga bien Dukagjini, ndërkohë që bashkësinë tuaj në Shkodër nen zë, me përçmim i qanin "çeqen"?! Me dashamirësi desha të pyes qoftë të djathtët apo të majtët e vendlindjes time, që ka 27 vite që bubërrojnë në politike - A keni menduar ndonjë here, se për çfarë u martirizua Deputeti historik, Profesor Kole Prela, në vitin 1946?

A i keni bërë pyetje vetes, se përse u flijuan Prof At' Gjon Shllaku, At' Benardin Palaj, At' Çiprian Nikaj, At' Dom Lazer Shantoja, Gjelo Lulashi, At' Gege Lumaj (ky shpëtoi por u dënua dy here nga 25 vjet)? Këta personalitete elitare bij të maleve të Leknisë, më tepër se shërbëtorë të Shën Françesku u ekzekutuan si eksponent të Partisë Demokristiane, të parës opozitë shqiptare, të vrare që në embrion!

Më thoni qoftë edhe një zonë të vetme, që ka paguar më shtrenjtë, me gjak martirësh aspiratën për demokraci, pluralizëm dhe parlamentarizëm të tipit Evropian se, Dukagjini?!

Është për qe me lot për faqe me ke përfaqësohet sot aspirata demokristiane e përçarë në disa fraksione minore, ndërsa bërthama dhe mburoja më e fuqishme e besimit tone, më vjetër është dhe vazhdon të mbete marginalizuar nga klanet feudo - otomaniste të politikës lajkatare që çirret e tundin flamujt konteporan. Politikanët e Tiranës, jo për mirënjohje, për shou ndërkombe të mbushen Bulevardin Qendror të Tiranës me banderolat ku stampoheshin fytyrat përndritura të 38 martirëve të kishës shqiptare përpara të cilëve u përul, u përlo dhe bekoj vetë Papa Françesku.

Një e katërta e këtyre heronjve të pa shok të shekullit 20-të, të vrare nga diktatura komuniste janë bijtë të Dukagjinit,

por mjerisht edhe baba i tyre është vrarë politikisht e pabesisht nga Klanet e Kampeve sundues të Tiranës. Ky diskriminim sistematik politik ka rrënjë të thella dhe ngjyrimë të ndezura regionale, të cilat na ndjekin pas si hije zeza të së shkuarës. Vete bashkësia dukagjinase duhet t'i këpusë një here e mirë dhe të çliroje vetveten nga kjo rrjete merimangash të zeza. Të gjithë e dëgjuam poteren madhe që u bë për mbetjen jashtë listave të Jozefina Topallit. Furtunë e madhe mediatike, bombë e pa pritur në radhët skalionet të vjetra të PD-së, madje s' kualifikimi i Xhozit u quaj një shputë e rënde ndaj shtresës së të përndjekurve politik, qytetarisë dhe religjionit katolik në Shkodër. More a është më padrejtësi më e madhe fshirja me gisht nga harta politike e Shqipërisë e një treve, e cila çdo sene elektorale prodhon një hambarë votash për tre deputet apo "Zonjës" së Fortë! Shoqja im e mirë e gjimnazit erdhi në politikë si lule e mbjellë në saks, luajti fort dhe me nerva të tendosura, la një gjurmë edhe për qytetin e vet, por nga politika mori gjithçka që mund të merrte, ndërsa përjetësinë si shenjtore nuk e meritojë.

Dukagjini, i cili ka mbështetur dhe Zonjën Topalli edhe Zotin Rama jo vetë që nuk ka përfituar as një investim me perspektive zhvillimore në këto 25 vite, por është kthyer në një shkretëtirë alpine, me migrator të ikur nga paniku. Në Dukagjin u shkatërrua gjithë rrjeti arsimor, shëndetësor dhe elektrik. dhe për një çerek shekulli nuk është hedhur një lopatë dhe ne rrugën e lare me gjak e të mbushur me lapidare të kësaj perle turistike Më tepër përkuajdesen shoqatat mjedisore për vaksinimin kundër tërbimit të dhelpave, se sa qeveritë shqiptare për ata pak të mjere që kanë mbetur në Dukagjin, të cilët nuk dine, se ku të mbyten.

Dukagjinasi duhet të përfaqësohen në çdo nivel dhe të mos rinë si fëmijë tekanjor i dënua nga prindi autokrat të mos hajë darkë nga që ka grisur librin dhe fletoren e detyrave. Dukagjini i shutuar, por edhe i turpëruar nga politika, e cila për interesat sa që e ktheu në Principate droge, duhet ti dal Zot vetit me zërin e bijve e bijave të vet. Është 100 herë turp dhe 1000 here marrëzi kolektive, që fatin e përfaqësimit tua lemë në dorë tjerëve. Kjo telekomedi imorale nuk mund të vijoje më.

Politika po theret përsëri bujarisht edhe tani me 25 qershor Dukagjinase o burra ku jeni?! - Dukagjinase mos votoni me sy mbyllur për të kënaqe epshin e atyre që ju duan për një ditë, pastaj ju thonë IK pirdhuni PIREDHUNI dhe nuk lënë gjë pa vjedhur për ju 364 ditë të tjera të motit.

FESTË E MADHË NË GJAKOVË

PËRKUJTOHEN ME MADHËSHTI DITA E ÇLIRIMIT TË GJAKOVËS DHE 80-VJETORI I LINDJES, LEGJENDË E KËNGËS POPULLORE SHQIPTARE, ISMET PEJA

Në Pallatin e Kulturës "Asim Vokshi" në Gjakovë, në prani të një pjesëmarrjeje të jashtëzakonshme të qytetarëve gjakovarë, por dhe të personaliteteve të shquara të artit dhe kulturës mbarëshqiptare, morën pjesë shumë yje në këtë skenë, ku u zhvillua ceremonia përkujtimore kushtuar Ditës së Çlirimit të Gjakovës, si dhe 80-vjetorit të lindjes dhe 63-vjetorit të karrierës së këngëtarit legjendë, të madhit Ismet Peja, organizuar nga Ministria e Kulturës së Kosovës dhe Komuna e Gjakovës.

Kjo skenë, për herë të parë është inauguruar me dramën "Fisheku në pajë" dhe në vitin 2000, kur Gjakova po digjej, në këtë skenë jepej drama "Dasma e trojeve tona", shkruar nga Fadil Kraja, një nga penat më të ndritura të dramaturgjisë tonë kombëtare, emblema e qytetit të shkodrës.

Fjalën përshëndetëse në këtë festë historiko-artistike e mbajti Kryetarja e Komunës së Gjakovës znj. Mimoza Kusari Lila, e cila në ligjëratën e saj evokoi ngjarjet e mëdha historike, heroizmin e pasqortë të djemve dhe vazhde kosovare, sakrificat e mëdha të një populli që përjetoi për dekada me radhë dhunën dhe reprezaljet e një shteti fashist.

Ajo në fjalën e saj solli në këtë mbrëmje historinë bashkëkohore të Kosovës Martire, sakrificat e një populli të tërë që kurr nuk u gjunjëzua për lirinë dhe pavarësinë e tij, por njëkohësisht e lidhi këtë histori me vëllazërinë e madhe që karakterizon Kombin Shqiptar, me Shqipërinë mëmë që hapi dyert e saj në çdo cep, nga Jugu në Veri.

Kjo histori është e freskët dhe një ndër qytetet që e ka përjetuar atë, ashtu si gjithë Kosova, është Gjakova.

Në gjithë historinë e Kombit Shqiptar, frymëzuese dhe evokuese të ngjarjeve kanë qenë këngët që nga eposi i kreshnikëve e deri në kohët tona, ku zërat e kushtimit për liri do të përcillnin artistët e mrekullueshëm, për t'i përrjësuar brez pas brezi heroizmat, që nga Shotë Galica e Azem Galica e deri tek legjendari i pavdekshëm Adem Jashari.

Nuk është se u zgjata shumë me ligjëratën e kësaj zonje të nderuar, por pikërisht këto ngjarje të shënuara kishin mbledhur në këtë mbrëmje, jo vetëm qytetarë gjakovarë, por edhe personalitete të shquara të artit dhe kulturës mbarëshqiptare dhe kjo tregonte kujdesin në radhë të parë të vetë Komunës së Gjakovës, por dhe të Ministrisë së Kulturës së Kosovës.

Unë pata fatin të isha atje dhe të përjetoja nga afër këtë festë të madhe, të organizuar si një spektakël madhështor, i ftuar nga Komuna e Gjakovës, së bashku me kompozitorin e shquar shkodran maestro Ilir Zoga dhe këngëtarja tashmë ikonë e këngës popullore shqiptare Mukades Çanga.

Ftesa jonë lidhej pikërisht me një këngë që kemi krijuar vite më parë për

këngëtarin e madh të këngës shqiptare, legjendën e gjallë të kësaj kënge, Ismet Peja, i cili në këtë natë magjike u nderua me çmimin jashtëzakonisht domethënë "Gjakovari i ndritur", si dhe me një Mirënjohje të veçantë në emër të Kuvendit Komunal të Gjakovës.

Përcaktimin më të veçantë për këtë ngjarje të shënuar në jetën 80-vjeçare dhe veprimtarisë artistike 63-vjeçare të Legjendës Ismet Peja, askush nuk e përcaktoi më bukur se sa vetë Kryekomunaria gjakovare Mimoza Kusari Lila, e cila më shumë emocion u shpreh para këtij auditori të jashtëzakonshëm "Unë jam sonte këtu me prindërit e mi, me bashkëshortin tim dhe fëmijët e mi, prej tre brezash që përjetojmë emocione nga i madhi Ismet Peja, të cilit i urojmë që të jetë jetëgjatë edhe për breza të tjerë".

Këtë aktivitet e përshëndeti edhe Sekretari Permanent i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Kosovës z.Veton Firzi, i cili në momentin që i dorëzoi Mirënjohjen të madhit Ismet Peja tha se emocionet janë të papërshtatshme për faktin se kam nderin që në emër të Ministrisë së Kulturës t'i dorëzoj këtë Mirënjohje legjendës së gjallë Ismet Peja, gjë që

edhe breza të tjerë këngëtarësh si: Znel Doli, Shkëlzen Jetishi, Edi Furra, Edi Ermeni, Afrim Muçiqi, Xhavit Sadiku etj, shoqëruar nga orkestra e mrekullueshme nën drejtimin e maestro Vllaznim Buxhovi, me një potpuri këngësh popullore nga perlat e kësaj shoqërie, ku këngëtarin më i dashur i Kosovës Shkëlzen Jetishi u shkëput nga ansambli i këngëtarëve duke iu drejtuar publikut të mrekullueshëm në sallën e tejmbushur dhe me një emocion të papërshtatshëm dhe të jashtëzakonshëm, me një dashuri e respekt për virtuozin Ismet Peja tha: "Aiii a është gjynah bre me u plak ky farë zanit?"

Publiku me këto fjalë magjike të Xenit shpërthei në ovacione dhe duartrokitje që nuk munguan gjatë gjithë këtij spektakli.

Moment i veçantë dhe befasues me plot dashamirësi ishte kur Baca Ismet i fton nga salla "Mjeshtren e Madhe" Shkurte Fejza e Miranda Hashanin, për t'u bashkuar me ansamblin e këngëtarëve në interpretimin e këngës tshme "Himn" për shqiptarinë "N'xhamadanin vija-vija".

Por ajo që kulmoj në këtë mbrëmje madhështore, ku agregat e orës nuk kishin më vlerë, ishte momenti kur doli në skenë këngëtarja e madhe shkodrane

moment salla e tejmbushur shpërthej në duartrokitje të fuqishme që rrallë herë ishin përjetuar në evente të tilla.

Këngëtarin Ismet Peja i emocionuar, tregoi se prej vitesh kishte pasur një ëndërr që të këndonte një këngë kushtuar idolit të tij, shkodranit të paharrueshëm Bik Ndoja "Nderi i Kombit", të cilën, tha ai, arrita ta realizoi me shumë sukses me vargjet e arta të poetit shkodran Ramazan Çeka, titulluar "Nuseron jarja me ty", me muzikë nga kompozitori Luan Dagistani. Kjo këngë u prit me shumë interes nga të pranishmit.

Ky spektakël ishte përgatitur dhe organizuar me shumë profesionalizëm, falë kontributit të çmuar të Drejtorit të Kulturës, prof. Meriton Ferizi, por njëkohësisht edhe kujdesit të studiuesit dhe muzikologut të shquar gjakovar prof. Behar Arllati, që të dy të njohur për vlerat që i kanë dhënë kulturës dhe artit në Kosovë.

Një rol të veçantë luan në këto evente skenike edhe prezantuesi i spektaklit, i cili arrin të bëhet një urë lidhëse mes skenës dhe publikut.

I tillë ishte Zeki Vehapi me profesion gazetare në Radio Gjakova, i cili menaxhoi artistikisht dhe profesionalisht çdo detaj të këtij aktiviteti.

Në këtë koncert kaq madhështor Baca Ismet iu drejtua me humorin që e karakterizon, këngëtarëve më të ri në moshë, duke i falenderuar ata për pjesëmarrjen e tyre në këtë natë magjike dhe duke iu premtuar se do të vinte të merrte pjesë edhe ai në 80-vjetorin e tyre. Kjo batutë u prit me shumë duartrokitje dhe me të qeshura në sallë.

Ky aktivitet, organizuar në mënyrë kaq madhështore, kishte planifikuar që me rastin e Ditës së Çlirimit të Gjakovës dhe 80-vjetorit të lindjes së këngëtarit të madh Ismet Peja, të nderonte për meritat e tyre artistë të shquar që kanë bashkëpunuar në vite, në mënyrë të veçantë për këngën dhe muzikën shqiptare, ku titujt, çertifikatat e nderit dhe të mirënjohjes u dhanë duke filluar nga "Gjakovari i ndritur" Ismet Peja e më pas akorduar poetit dhe publicistit Ramazan Çeka, kompozitorit Ilir Zoga, për të vazhduar tek krijuesi i madh tiranas, autor i mbi 200 këngëve, Muharrem Gurra (pas vdekjes), që iu dorëzua të birit Ramazan Gurra.

Merita dhe lavdërime, ashtu siç ndodh gjithmonë, vijnë në fund, për punën e madhe që kanë bërë në transmetimin e këtij aktiviteti, për televizionin "Syri Vizion" i Gjakovës, televizioni RTV 21, si dhe RTK, Televizioni Kombëtar i Kosovës.

Kjo natë magjike u mbyll me një darkë madhështore në Restorant "Presidenca", ku deri në orët e vona të natës, festa vazhdoi.

**Përgatitur nga Ramazan ÇEKA
Gjakovë, qershor 2017**



ndodhë për harë të parë nga kjo Ministri.

Kështu Ismet Peja, tanimë me 80 vite mbi supë, por me një eksperiencë të madhe artistike, me një reputacion të pakrahueshëm, u ngjit në skenë vital, sikur të ishte shumë vite më i ri dhe surprizoi të gjithë të pranishmit kur ai interpretoi këngën e parë të fillimit të karrierës së tij, të kënduar në vitin 1954, titulluar "Këndo o zogu i malit", por tashti së bashku me djalin e tij Vegimin dhe nipin Leonardin, për të treguar kështu se tradita në këtë familje vazhdon edhe sot e kësaj dite.

Më pas ai këndoi edhe një nga perlat e këngës popullore shqiptare "Kur t'i shoh dy sytë e shkruar".

Më pas koncerti vazhdoi rrjedhën e tij sipas programit me këngëtarin nga Prishtina Ymer Bajrami.

Këngëtarin Ismet Peja e shoqëruan

Mukades Çanga.

Ishte momenti më interesant dhe më i bukur i këtij spektakli madhështor, kur ajo me zërin e saj brilant interpretoi një këngë kushtuar këtij virtuozit të këngës shqiptare, titulluar "Zemrat pesh' çon zani jot", me tekst nga autori i këtij shkrimi dhe muzikë nga maestro Ilir Zoga, që erdhi në këtë spektakël si një dhuratë nga Shkodra, nga qyteti, këngët e të cilit, Ismet Peja i këndoi për gjithë jetën.

Interpretimi brilant i Mukades Çangës, u prit me ovacione dhe falenderime vëllezërore nga të gjithë të pjesëmarrësit, duke e rikthyer disa herë në skenë.

Këtë sukses ajo me modestinë e saj u përpoq ta ndajë me autorin e tekstit Ramazan Çeka dhe kompozitorin e talentuar Ilir Zoga, të cilit iu drejtua para publikut për t'u ngritur në këmbë dhe në atë

VERSHIMET E NJË PYLLTARI

- ME RASTIN E 60 VJETORIT TË LINDJES TË INXHINIER GJON FIERZA -

Një jetë më shumë, një gëzim e buzëqeshje kënaqësindjellëse në një shtëpi në fshatin Plan të Pultit 60 vite më parë. Prindërit, Marashi e Prena (e kishin djalin e parë), familjaret e tjerë, të gjithë u gëzuan për këtë djalë që lindi. Vitet kalonin dhe djali imcak rritej në atë familje të thjeshtë malësore në një mjedis gjeografik që do ndikonte fuqishëm në jetën e tij. Fshati Plan, një hapësirë e shtrirë në pjesën fundore të Alpeve, një mjedis natyror i skalitur me bukuri, ku burojnë ujëra të kthjellëta e të ftohta të lumit Kirit, ku lartësohen majëmalet qeleshebardhë nga dëborat e përjetshme. Plani, njëri prej fshatrave të Pultit, me emër, i dëgjuar në histori për qëndresën ndaj çdo pushtuesi, për besë e bujari, për njerëz të ditur dhe me emër, ku me mund e sakrificë sigurohej jeta nga këta malësorë, ishin mjedisi social e shoqëror, ku do të kalonte fëmijërinë dhe rininë e hershme kolegu ynë, personazhi këtij shkrimi; Gjon Marash Fierza. Ai, shkollimin fillor dhe tetëvjeçar e mori në vendlindje, duke spikatur që në vogëli për cilësitë dhe inteligjencën e moshës dhe dëshirën për shkollim. Me shumë dëshira dhe aspirata për jetën, i riu Gjon Fierza, do të zbriste në qytetin e Shkodrës për t'u shkolluar. Tek e kujton atë kohë, Gjon thotë se i ati Marashi, gjithnjë i thoshte: "merru vetëm me shkollën dhe librat, asgjë nuk është para këtyre"! Gjon shton se ndihmesë të madhe, ai që mori si thonë për dore, për në Shkollën e Mesme Pyjore Shkodër, ishte daja i tij Deda (Sokoli). Gjon thotë se ëndërronte të bëhej; mësues, doktor apo gazetar, por e drejta e studimit ju dha për teknik pyjesh. Duket, sapo arriti në Shkollën Pyjore, natyra me pyjet e vendlindjes do ta thithnin përgjithmonë të gjithin në fshehtësitë e tyre. Djaloshi me zell, hyri në një botë krejtësisht të re atë të pylltarit; që do t'u shërbente gështenjave në Pult!. Kështu, nga viti në vit, plotësohej mozaiku profesional i teknikut të pyjeve. Ai mbaroi arsimin e mesëm pyjor, me rezultate të shkëlqyera. Por, pylltari Gjon Fierza vështronte larg në horizontet e ardhmërisë së jetës profesionale, gjithnjë në formim shumëplanësh, gërmonte në të fshehtat e kohërave. Punoi dy vite 1976-1978 si teknik pyjesh në Pult, në moshën 19 vjeçare dhe tek kujton për atë periudhë, të përmend kolektivin e parë të punës me njerëz të ndershëm dhe të përkushtuar, disa objekte me pyllëzime që shumë orë të natës e linin pa gjumë. Ai kujton se ndjente gëzimin për objektin e geshtënjës dhe pishës "Mbi Telaj" në Gjuraj që po zhvillohej shkëlqyeshëm pasi toka; por dhe mbrojtja nga banoret vendas ishte mjaft e mirë. Jam ndjerë shumë i mërzitur deri në dëshpërim për dështimin e pyllëzimeve me gështenjë në "Mbi Than" në Plan dhe objekti me pishë "Mbi Alvana" në Khan, këto kulloteshin nga bagëtitë, që i çuan fidanët deri në shfarosje. Në dy vite punë si teknik pyjesh në Pult, ndoshta 20 - 30 km rrugë

në këmbë i bëja çdo ditë, kujton Gjon Ai saktëson se lëvizte nga Kodra e Kujës për në Qafë të Mgullës dhe kthim. Ndoshta aty zë fill sakrificat dhe përkushtimi për profesionin e pylltarit dhe përballja me vështirësitë e ndryshme.

Dhe ja çasti tjetër gëzimshumtë, që duhet ti jepte fund asaj lodhje, i duhej të përgatiste valixhen e drunjte, ndoshta dhe ti thoshte lamtumirë vendlindjes, tashme stacioni tjetër ishte Tirana. Gjon të kujton si e mori vesh që i doli e drejta e studimit në Fakultetin e Pyjeve; Ishte mesgushti 1978, unë po zbatoja disa punime në rrallime në Karmën e Kirit. Nga



pasditja pashë zisin e kooperativës Pultit, që ndaloi diku poshtë objektit të punës. Dikush më thirri dhe zbrita ta takoja. Në makinë pashë, ishte daja im Dede Sokoli, i cili me tha se kanë dalë shpalljet për studimet e larta, prandaj duhet të zbrësim bashkë në Shkodër. U përshëndeta nga larg me punëtorët, hipa në makinë dhe ika për në Shkodër. (Në xhep për një rast të tillë mbaja pasaportën dhe 1 000 leke). Kur arritëm në Shkodër ra nata dhe ashtu në errësirë shkuam tek "Gjimnazi 29 Nëntori" në dritaret e të cilit ishin afishuar listat për studime. Me shkrepës bëmë ndriçimin, filluam të lexojmë listat, kur shkrepëset po na mbaronin diku ne listën e fundit, lexova emrin tim, në Fakultetin e Pyjeve. Ishin emocione dhe një gëzim i papërshkruar në atë çaste dhe një përqafim i ndjerë nga daja im. Ashtu të gëzuar, kujton Gjon shkuam dhe darkuam tek Turizmi i vjetër, natën e kaluam jashtë në Lulishte pasi nuk gjetëm vend në asnjë hotel.. Studimet në Fakultetin e Pyjeve, Gjon, do ti kryente në periudhën 1978 - 1982, me rezultat shumë të mira; u diplomua inxhinier pyjesh dega e përgjithshme.. Pas diplomimit si inx-

hinier, dëshira dhe ëndrra e tij ishte ta ndërtonte jetën në Shkodër. Kjo nuk u mundësua, ndonëse e mori emërimin nga Ministri si specialist në Kombinatin e Drurit Shkodër. Ai u paraqit aty dhe qëndroi për rreth një muaj, u thirr një ditë dhe ju komunikua se me një urdhër tjetër të Ministrit, ai ishte riuemëruar në Pukë, Fushë-Arrëz. Kjo një padrejtësi e kohës që Gjon e pati në kurriz dhe që dyzoi të shkante apo jo atje. Ndoshta me shumë se një muaj ai në Tiranë u përpoq që të anulohet ai urdhër; por që e pamundur. Sigurisht në ato vite ishte me rreziqe të braktisje punën dhe te mos zbatoje urdh-

shqiptare. Inxhinieri i sapodiplomuar do të hartonte projektet teknologjike të shfrytëzimit pyjeve në Stabilimentin e Tuçit, do t'i ndiqte ato në zbatim hap pas hapi, duke kryer shfrytëzimin racional, duke siguruar ripërtëritjen natyrore të domosdoshme; duke realizuar shifrat e planit e plotësim e kërkesave të mëdha për lëndë druri. Janë net pa gjumë me punime në zyrë dhe me dhjetëra km ecejaket në terren çdo ditë; me sharrëtarë, mekanizatorë e shoferë. Ai jetoi në gjirin e sharrëtareve në sektorin Tuçit i "fshehur" midis pyjeve në thellësi e malit të Munelles. Duke ndjekur me përgjegjësi teknike e ndershmëri punën, ai fitoi respektin e kolektivit jo vetëm në Tuç, por dhe tek kolektivi inxhinier - teknik në qendër, ai u bë i njohur si "inxhinieri i Tuçit". Pas më shumë se gjashtë viteve në Tuç, transferohet në qendër si inxhinier i mekanizmave të ndërmarrjes, një ndër detyrat më me përgjegjësi për një ndërmarrje të tillë, me shumë traktorë, teleferikë, vinça dhe dhjetëra motosharra. Korrektësia, përkushtimi dhe bashkëpunimi, me punëtorët, me kolege dhe drejtuesit e bënë të suksesshme punën e tij në këtë sektor. Një punë tjetër më e vështirë, disi jashtë profesionit dhe dëshirës, por për nevojat e Ndërmarrjes siç thuhej në ato vite, duhet të merrte përsipër. I vlerësuar për korrektësinë, përkushtimin dhe intuitën e tij, inxhinier Gjon Fierza emërohet kryetar i Degës Furnizim - Shpërndarjes për dy vjet. Këtë periudhë Gjon e vlerëson si më të vështirën në punën e tij të deri sotme, kur po afron katër dekada në profesion. Ai të kujton se çdo ditë komunikonte me dhjetëra drejtorë ndërmarrjesh nga gjithë Shqipëria, shpesh me ministra e kryetar komitetesh, pasi kërkonin furnizim me lëndë drusore, dërrasa, trupa dhe dru zjarri, e të tjera, Gjon, kujton "shpesh here në telefon i thuhej nga ministri ... nëse në Tiranë, Shkodër, Lezhë, e të tjera, nuk dërgohet kuota e caktuar me lende drusore, mund të përfundosh dhe "në burg"?! Një ministër në ato vite në telefon duke bërëtitur që "të këshilloj se duhet mbash veshur dy palë pizhame", se në qeli e ke vendin; nëse Tirana do mbetet pa dru zjarri apo Fabrika e letrës Lezhë, nuk do prodhonte letër për gazetatat, e të tjera. Ishte periudhë e vështirë, kur ekonomia dhe në tërësi sistemi komunist po "jepte shpirt si i dështuar". Më pas në vitet 1990 - 1993, punon si kryetar i Degës Teknike. Në Fushë-Arrëz, ai krijoi familjen, u martua me Irenen (origjine shkodrane) ku i lindi djali i madh, Orioni. Me ndryshimet e thella politike, ekonomike që po ndodhnin me shpejtësi, Gjon kërkoj përsëri të kthehej në Shkodër, tashmë si mësues në Shkollën Pyjore. Ish drejtori shkollës, Zef Shpori, që e njihnte që nënës, por dhe si inxhinier u përpoq ta merrte si pedagog, por dhe kjo nuk u realizua, pasi duhej "një vendim partie" për një punësim të tillë. Por, jo vetëm kaq "sëmundja e

vjetër" kur dukagjinasi, për tu punësuar dhe jetuar në Shkodër e kishin shumë të vështirë nga qeverisja e kohës, akoma nuk ishte zhdukur.

Inxhinier Fierza, në vitin 1993 shkëputet nga qyteza e sharrëxhinjve dhe emërohet në Drejtorinë e Shërbimit Pyjor Lezhë, ku për pesë vjet kreu me përgjegjësi profesionale detyra nga specialistit deri tek shefit të Seksionit Teknik. Aty, ka treguar aftësitë e tij profesionale në fushën e silvobiologjisë, ai realizoi me sukses projektin e parë pilot për pyjet e Komunës Blinishtë me mbështetjen e USAID. Ambiciet profesionale, kërkesat për një jetë më të mirë, për shkolimin e dy djemve; e motivuan Gjonin të lëvizë përsëri. Ai transferohet nga Lezha në Institutin e Kërkimeve Pyjore, Tiranë, si kërkues shkencor në Sektorin e Silvokulturës, ku punoi rreth një vit. Bashkëpunimi i vendosur në Lezhë me Projektin e Pylltarisë Private, i financuar nga USAID i ofruan mundësinë si konsulent në këtë projekt. Ai punoi në këtë projekt për rreth tre vite. Gjatë kësaj periudhe mbështeti hartimin e planeve të mbarështimit dhe transferimin e pyjeve në rreth 30 komuna, në disa qarqe të vendit. Gjoni, është ndër specialistet e parë në vend që u mor me "Pylltarinë komunale", beri disa kualifikime dhe trajnime në ngritje të aftësive profesionale në këtë fushë. Pas mbarimit të projektit USAID, ai kalon për një vit tek Projekti i Regjistrimit të Pasurive, për tu kthyer përsëri tek sektori i pyjeve në Projektin Shqiptar të Pyjeve në pozicionin e specialistit të Marrëdhënive Publike dhe Komunikimit. Ai ndërmori përsipër një punë të re duke zëvendësuar një gazetar, puna kryesore ishte përgatitja e

materialeve dhe fushatave me karakter njohës dhe ndergjegjësuës, botimin e Buletinit Informativ të Pyjeve", e të tjera. Ishte kjo punë, që i dha disi kënaqësinë e realizimit të një ëndrrë kur ai mund të bëhej "gazetar"! Periudha 2002 - 2004 si specialist informimi dhe komunikimi i shërbeu atij si një shkollim tjetër në propagandën e shumëfishtë mbi pylltarinë, e cila po ndiente krizën e thellë në politikën pyjore, në ndryshimet e thella që

do të duheshin kryer në pronësi, ligje organizim vertikal e horizontal. Këto vite të shkruarit e artikujve për pylltarinë e drejtoj dhe në një aspekt tjetër, duke gërmuar në historinë e pylltarisë shqiptare, në arkivimin, skedimin e materialeve e fakteve, në fushën e shkencës së pylltarisë, të historisë, të veprimtarisë së inxhinierëve e teknikëve të pyjeve në kohë të ndryshme. Me këto shkrime paraqiti "modele" të specialistëve nga mund të mësohet dhe të veprohet sot. Me një mënyrë të shkruarit thjeshtë, ai ka synuar që brezi i ri jo vetëm ti njohë ata pylltarët në kontekstin historik, por dhe të mësojë dhe frymëzohet nga puna e tyre. Ndoshta janë deri tani mbi 40 personalitete më me emër, por dhe specialistë të thjeshtë të pylltarisë shqiptare që zënë vend në shkrimet e tij, të botuar në gazeta dhe revista. Ai dhe tani vazhdon në këtë hulli të shkruarit duke gërmuar në jetën dhe punën e atyre që nuk jetojnë dhe po, që para viteve 90' Shqipërinë e lanë të veshur me pyje. Tek Gjoni, tashmë jo vetëm publicistika që vazhdon, por ai synon diçka më shumë, që tu shërbejë kolegeve, studentëve, si modeli i bashkëpunëtorit

Pyjeve; specialist në Ministrinë e Mjedisit; shef i Seksionit Teknik në Drejtorinë e Pyjeve të Tiranës, që nga viti 2014, vazhdon si specialist monitorimi në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit. Në vitin ka marrë 2010, "Master në shkencat Pyjore", pas mbarimit të studimeve të thelluar pasuniversitare pesëvjeçare në Fakultetin e Shkencave Pyjor. Si specialist pasionant ka shkruar dhe ideuar shumë projekte për pyjet kryesisht komunal dhe aspekte mjedisore. Së fundi ai bashkëpunoi në hartimin e Planin të Parkut Rajonal Zagori - Gjirokastër. Në vitin 2000 ai kujton se inicioj, hartoj dhe mbështeti në zbatim të punimeve të parin projekt për pyjet komunal në Shkodër, atë për Pyjet e Komunës Pult. Gjoni thotë se, nga të pakta mundësi që mu dha të mbështesja pyjet e vendlindjes. Por më shumë, se çdo projekt vlerëson: se pyjet e vendlindjes - Gështenjat e Pultit: nga Kodra e Kujës deri në Kasnec të Kirit i ka bekuar Zoti, jo vetëm me funksionin e shkëlqyer si pyll, ato shpesh kanë shuar urinë në kohë të ndryshme të banorëve të Pultit. Gështenjat nuk u dëmtuan në komunizëm dhe as në këtë tranzicionin e stërzgatur. Sipas

Gjonit, në Pult nuk mund të mendohet jeta pa gështenjat që shtihen kudo. Në maj - qershor kur gështenja lulëzon ai të thotë se: Pulti me shtrirje nga Gryka e Karmës Kirit deri në qafë të Boshit; është ndoshta peizazhi më i bukur që mund të imagjinohet, unikal dhe jo vetëm në Shqipëri. Për fatkeq ky mjedis ende është i parritur nga ekoturistët, pak njerëz i kanë shijuar vlerat e natyrës në pjesën e sipërme të basenit të lumit Kir - krahina e Pultit".

I gjithë jetëshkrimi i inxhinier Gjon Fierzës, është një binom: përpjekje dhe suksesi. Vetëm me punë të ndershme, ka mundur të sfidojë këtë kohë tranzicioni me konjuktura e dallavere. Ka arritur "maja në profesion", por asnjëherë nuk është bërë drejtor. Puna e Gjonit e disa kolegeve si ai, nuk kanë marrë vlerësimin e meritur. Mos angazhimi në klane politike dhe të korrupsionit, i ka lenë në hije si personalitete publik dhe në ngritje në karrierë. Treguesi më i mirë për politikën e ndjekura në pyje në këto 25 vite, si pjesë e këtij tranzicioni është sot; gjendja e mjeruar e pyjeve të Shqipërisë që kul-

moj me shkrimin shërbimit pyjor në Shqipëri në vitin 2014. Tek themi këto, duket se ka një kundërshti me vlerat e punës e Gjonit dhe disa kolegeve si ai, por kjo është dhe një ndër argumentet që vërteton këtë gjendje të keqe të pyjeve, kur nuk vlerësohen dhe drejtojnë sektorin specialistet e vërtete dhe pasionet të pyjeve.

Pasioni për pyllin dhe njerëzit që punojnë në to, e ka shtyrë Gjonin që i kudo gjendur me aparat në dorë, ai tashme konsiderohet si "profesionist i fotografive në mjediset pyjore", i motivuar ka shkruar skenar e realizuar dokumentarë për pyjet, të përgatisë materiale të ndryshme informative dhe ndergjegjësuëse për mbrojtjen e pyjeve, e të tjerë. Pyjet dhe shërbimi pyjor shqiptar në vite - Shënime Historike, viti 2013, me bashkautorë inxh. Kolë Malaj e Janaq Male, një botim voluminoz me shumë informacion për pyjet shqiptare në dinamikën e tyre. I ilustruar me rreth 700 fotografi, kulmon në veprimtarinë botuese të Gjonit. Duket se puna nuk ka të ndaluar në shkruar dhe sot krahas ushtrimit të detyrës së përditshme, ka skicuara dhe botime të tjera sigurisht kërkon mbështetje për botim. Po t'iu hedhësh një vështrim librave, monografive, artikujve të tij, të shumtë, vëren të shprehura qartë, zemërgjerësinë, shpirtin e kolektivitetit, të respektit ndaj kolegeve e bashkëpunëtorëve, ndaj punës e sakrificave të tyre. Msc. Gjon Fierza, në gjashtëdhjetë vjetorin e lindjes vjen me shpirtin e tij, klorofilian, me kurorën e gjelbër të arritjeve, me modestinë e intelektualit të suksesshëm, që imponon respektin e dashurinë e kolegeve pylltarë dhe gjithkujt që e ka njohur ndër vite.

Si veprimtar shoqëror Gjoni, është mjaft aktiv, përveç se e njohim si anëtar të disa organizatave mjedisore dhe të gazetareve të bujqësisë, e kemi parë të jetë dhe një anëtar aktiv i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", dega në Tiranë.

U tha diçka nga sa shumë mund të shkruhej për kolegun tonë Gjon Fierza, si bir i Dukagjinit. Dukagjini - "Nderi i Kombit", dekoratë e merituar për njerëzit, personalitetet e asaj treve me kontributet e tyre në shekujt deri sot.

Inxhinier Gjon Fierza, si një "qelizë" e asaj bashkësie (gjithnjë ndjehet krenar për origjinën), Dukagjinin e nderon me sa ka arritur dhe kontribuar kudo ku ka punuar dhe jetuar.

Dr. Selman MEZIU,
Ing. Kleanthi MANDI



me kolegët, realizon disa botime monografike, manuale të ndryshme; për pyjet, zonat e mbrojtura, e të tjera. Janë deri tani mbi dhjetë tituj botimesh si autor dhe bashkautor që zënë vend me rëndësi në bibliografinë e pyjeve, janë me dhjetëra artikuj të botuar në shtypin shqiptar apo dhe jashtë vendit.

Pas vitit 2004, në Tiranë; Gjon Fierza ka punuar si: shef i Seksionit të Sivikutures në Drejtorinë e Përgjithshme të

LOTI I TRETUN

Addio!
Ket' fjalë të huej belbëzove kur ike
e nji kokërr loti të treti n'errsinë
te pema n'park.
Mot i keq me shi e borë ka me ba ket' vit
e gjethët për herë të parë bien n'vjeshtë
pa thanë emnin tand.
Kur stinët të ndërrojnë,
e toka të mbushët me lule e bar,
mos ndiz qiri me kerkue
relikën e syve tu
të tretun n'ket' vend ka herë.
Tash vonë
vala e detit një medalion malli me solli
kaq larg,

as mesazh, as fjalë nuk munda me lexue,
por një sterpikël deti fluturoi n'brig
me kuvendë me mue
e faqja m'u lag.
Ndoc Selimi, Milano

VARGJE NË FUSHATE...

Ninushëm
po e shkojnë jetën Shqiptaret..
me kafe e me fjale jetojnë.
Nuk besojnë Krishtin as Muhametin,
por rrehen pas Partisë që dashurojnë!?
Kreshme e Ramazan u shkon moti,
një komb i zhytur në varfëri,
popull qyqar dhe i pa fat
që kurrë nuk gjeti kënd me i pri.

Zihen e shahen si qentë,
Ata që kanë pare me kërkua pushtet.
Ata që për një cope karrige.
e shesin edhe babën e vet.
Ninushëm i shoh shqiptarët,
në kafe ditë e nate...
në dreka e iftare po kënaqën ketë muaj,
Se kemi Ramazan e fushate.
Shqiptarët një zjarr i lashte,
që shitën, blihen dhe konvertohen
digjen e nxjerrin vetëm tym,
Me mu..... e vet gjithmonë krenohen.
Barkthate e ninushem gjithmonë
të parët për fjale e poshtërsi.
Zoti na dha tanë t' mirat..
Por kurrë nuk patëm drejtues as qeveri.
Lulash Brigja

Shoqata Atdhetare “Dukagjini, sjell Malsorët e Rugovës në Bibliotekën “Marin Barleti”, në Shkodër

Në fund të muajit maj në Bibliotekën e Shkodrës “Marin Barleti” dhe nën kujdesin e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” u organizua promovimi i dy veprave historike të autorit nga Rugova z. Fazli Muriq; “Koshtani heroik i Rugovës Kreshnike” dhe “Rugova kreshnike dhe e kaluara e saj historike”. Një projekt i nisur që në janar pas një bashkëpunimi me mikun tonë të përbashkët Ali Daci.

Pata nderit të mbaj fjalën e hapjes dhe në mendimin tim modest të vlerësoj autorin dhe vlerat që mbartin këto vepra, rëndësinë që kanë për historinë, shpalosjen e vlerave heroike të figurës së pavdekshme të dr. Ibrahim Rugova.

Si asnjëherë tjetër ambientet e bibliotekës ishin të mbushura plot me njerëz të artit dhe kulturës, kritik, historian, studiues, poet, shkrimtar, veprimtar e të tjerë.

Z. Ndue Bacaj bëri një analizë të detajuar të dy veprave dhe përcolli shumë emocion tek auditori.

Nga Rozhaja na nderoi me prezencën dhe fjalën e tij z. Ali Daci, që është edhe redaktori i dy veprave. Në fjalën e tij falënderoj për mikpritjen dhe bashkëpunimin e vijueshëm mes Malësisë, Kelmendit e Dukagjinit.

Analizoi veprën dhe ndau mbresat e tij z. Kadri Fikaj duke na kujtuar rendësinë e bashkimit të vlerave në rrënjët natyrale.

Përsëriten, me fjalë të ngrohta: z. Aleks Dushi, Kadri Ujkaj, Ilmi Kurti, Farida Zmijani - Ramadani e Rita Shkurtaç.

Në fund autori dhuroi libra dhe një kafe mes miqve ku u këmbyen mendime të lira dhe libra!

I urojmë suksese autorit dhe gjithë pjesëmarrësve!

Kjo veprimtari ishte e veçantë nga lloji, nga pjesëmarrja dhe nga drejtimin i saj. Malësi - Dukagjin, Shqipëri - Kosove e

gjithë shqiptaret kudo ndodhur, jemi vëllezër, qeshim e qajme së bashku. Me këtë moto u përgatitë e u zhvillua kjo ceremoni, e cila është dhe një shembull më



shumë, për të treguar jo vetëm që jemi një, por dhe për të bërë dhe më shumë së bashku pune më të mira.

Autorit të librit, Fazli Muriqi i urojmë

krijimtari të tjera e më me nivel dhe ti promovojë po në Shkodrën tonë.

Duke përfutur nga kjo ceremoni, në emër të Kryesisë së Shoqatës Atdhetare

suruar vlerat historike, etnografike dhe artistike të Dukagjinit”

Në fund, një kafe e përbashkët që shërbeu më tepër për bashkëndarje e



“Dukagjini” autorit Fazli Muriqi, ju dha titulli “**Mirënjohja Martin Camaj**”, me motivacion: “Për kontributin e madh të dhënë në zbardhjen e historisë shqiptare, me theks të veçantë për luftëtarët e Shqipërisë Etnike, për Shqipërinë e Bashkuar. Për bashkëpunimin e Shoqatave tona për ruajtjen e trashëgimisë së traditave të përbashkëta kombëtare” Gjithashtu, në emër të kryesisë, ju dorëzua titulli “**Mirënjohja e Shoqatës Atdhetare Dukagjini**”, këngëtareve të mirënjohur të zonës së Dukagjinit: Gjovalin Prroni, Gjovalin Shani, Pëllumb Vrinca dhe Gëzim Zefi, me motivacionin: “Për mjeshturin e shpalosur në krijimin dhe interpretimin e folklorit. Për kontributin e dhënë në veprimtaritë e Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, duke paraqitur e pa-

komunikim me të gjithë pjesëmarrësit, ...

Faleminderit të gjithëve për kontributin e dhënë për realizimin e kësaj veprimtarie me shumë vlera kulturore .

Nga Peja, nga Rozhaja, nga Malësia e Madhe dhe Dukagjini ... ishin në Shkodër. në një takim letrar në Djepin e Kulturës.

Falënderojme mundësorët që bënë të mundur realizimin e kësaj veprimtarie, si: autorin e librave, zotëri Fazli Muriqin, Roza Pjetrin, Anton Kosterin e Mirela Gjoni, me urimin popullor: “Paçin e dhëncin!”.

**Mimoza Rexhvelaj
Lulash Brigja**

Të shmangemi sa të jete e mundur nga folklorizmi



Jemi mbledhur për diçka të veçantë, jo nga lloji i veprimtarisë që zhvillohet, por se ka ardhur në Shkodrën tonë, një nga Kushtani heroik, zotëri Fazli Muriqi, për të promovuar dy vepra të veçanta

për nga lloji, historiko – monografike, kushtuar fshatit Kushtani dhe krahinës së Rugovës, me titull “Kushtani heroik i Rugovës Kreshnike” dhe “Rugova Kreshnike dhe e kaluara e saj historike”, me nismën e zotëri Ali Daci, Kryetari i Manifestimit Letrar, i pagëzuar “Ora e Maleve”, në Rozhajë, që e organizon Shoqata Atdhetare “Dukagjini”, dhe ketë ceremoni e drejton poetja e talentuar nga Malësia e Madhe, zonja Mimoza Rexhvelaj. Prandaj e theksoj si një risi e veçantë, e cila na bën më

shumë të ndjeshëm për përgjegjësinë që na është ngarkuar e kemi marrë përsipër, ndaj rolit e besimit që na është ofruar, që na është dhënë.

Në cilësinë e studiuesit, kam bërë përpjekje ti studioj dhe për këtë më lejoni të jap opinionin tim modest.

Zotëri Faslli, ka bërë një punë të madhe, një pune voluminoze dhe gjithashtu ka bërë përpjekje që banoret e fshatit Kushtani të kenë sa më pak kundërshti, sepse nuk është e lehtë të bësh monografi të tilla historike, se ato duan shumë hulumtime, duan shumë korrektësi dhe duan shumë përfshirje. Mendoj se Fazliu ja ka arritë plotësisht qëllimit në këto drejtime që theksoj.

Ju lumtë!

Që në fillim, te monografia e fshatit

Kushtani, na thekson, se banorët e tij janë banorë me origjinë nga Kelmendi, po aq kreshnik sa dhe vete Kushtani. Pra janë banorë nga Selca, Vukli, Lëpusha, Koshnja, Nikçi, Boga, nga Muriqi, e fshatra të tjerë të Malësisë së Madhe apo nga Shala, të cilët qoftë veç e veç apo së bashku kanë një histori të papërkulur në lufte me otoman dhe me shqija, një luftë, që asnjëherë nuk pranuan të nënshtrohen dhe të qëndrojnë me çdo sakrificë kelmendas, shqiptar. Pra, ketë e thekson me shumë force Fazliu, që vërteton më së miri atë histori të shkëlqyer atdhetare të kësaj krahine, të kësaj treve në shekuj, dhe këta kushtanas kanë mbete besnik e këtyre dhuntive. Ju lumtë!


Ka rendësi të madhe e vërteta, se ata e shumë banorë të krahi-

Mrëdita për "Heroin e Popullit", Dedë Gjon Lulin

Ishte vërtet një ditë e mrekulueshme, 10 qershori 2017, në Blinisht të Mirditës. Një ditë nderimi, përjetimi dhe respekti për legjendën malësore, Heroin e Kombit, Dedë Gjon Lulin dhe 7 vëllezërit e tij mirditorë: Mark Llesh Doda, Ndue Kolë Pjetri, Zef Ndue Gjoka, Prend Cub Deda, Prend Gjokë Skanaj, Bibë Mark Lula dhe Llesh Deda, që u vranë barbarisht në Lajthizë - Orosh të Mirditës në krah të tij, 102 vite më parë.

Lavdi 7 dëshmorëve mirditas si dhe "Heroit të Popullit", Dedë Gjon Luli, gjithashtu nderim dhe respekt për Preng Ndue Lleshin, mirditorin patriot, që ideoi, investoi dhe realizoi në ngritjen e këtij obelisku fare pranë "Rrugës së Kombit", duke pasuruar fisnikërisht historinë tuaj dhe të kombit. Ishte ky një akt qytetarie brilante, altruizmi dhe patriotizmi të pashoq, që nderon jo vetëm historinë e familjeve të bijve të lavdishëm, dëshmorë të Atdheut dhe Mirditën, por nderon mbarë kombin shqiptar me frymëzimin që rrezaton mbarëkombetarisht, në krah të Rrugës së Kombit si një dritë e pashuar rrezatimi patriotik iluminist, në dobi të zgjidhjes së çështjes sonë kombetare,

ëndrra dhe ideali i djalit të Malësisë së Madhe, "Hero të Popullit" Dedë Gjon Luli" dhe i 7 bashkëvëllezërve të tij mirditorë, të nderuar si "Dëshmorë të Atdheut" nga viti 1984.



Ata u vranë barbarisht, sikur u masakruan në Shpellën e Akullit, Orosh nga prita e pabesisë tradicionale serbe, në bashkëpunim me tradhtarin më të madh të kombit shqiptar, Esat Pashë Toptanin, më 24 shtator 1915, akt që e përcjell në mënyrë të përkryer fjalë e zjarrtë e poetit të talentuar mirditor, mikut tim, Viktor Gjokolaj në librin e tij "Shira dhe Ylbere": "Shtatë gurra të ngrohta gjaku / Rrodhën mbi akull / E shpella e Akullit nuk u shkri / As gjaku nuk u ngri ... / ... Ka mbi 100 vjet", si kurse studiuesi dhe publicisti i shquar Gjovalin Ndoja në lbrin e tij "Ylbere mbi Lajthizë" kur shprehet: "Këta ishin dhe janë 7 Dëshmorët lajthizakë, që nën hijen e Dedë Gjon Lulit, heshtin duke pritur atë dritë të merituar, për veprën madhore, që zvoglohet nga ata që harrojnë vjet e vet. Ata janë përsëri në besën e Mirditës, në kujtesën e gurëve të përgjakur, në ahishten e djegur, te zogjtë dëshmitarë, në vajtimin e nënave e këngët e dasmave, për t'i thënë Malësisë së Madhe se nuk e lamë vetëm Dedën, por vdiqëm bashkë me

të".

Si i ftuar nga Qarku Lezhë, së bashku me kryetarin e shoqatës "Malësia", z. Ilmi Kurti, në këtë eveniment nderi dhe krenarie, sa lokale, sa kombëtare, u ndjeva i lumtur nën ndjesinë dinjitoze të një treve që, siç di të nderojë vetveten, di të nderojë në kodin e vet po kaq denjesisht edhe mikun duke e nxjerrë ende më të mirë, më të plotësuar shpirtërisht nga trevesa e vet. Nderuan këtë ditë sa të pakrahasueshme për nga vlerat historike dhe humane, që ofron po aq nga interesi i jashtëzakonshëm për jehonën madhështore të saj, edhe nga autoritetet më të larta të Qarkut Lezhë dhe kryetarët e bashkive Rrëshen dhe Lezhë, me praninë dhe fjalën e tyre të zgjedhur me kujdes, në nderim të këtij eventi historik. Personalisht pata kënaqësinë të përjetoj këtë ditë të paharruar, po aq sa si studiues, kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të M. Madhe "Nderi i kombit", siç e theksova edhe në përshëndetjen time të rastit, madje shumë më tepër se kaq, si njëri nga malësorët e M. Madhe "Nderi i Kombit", origjina e gjakut të të cilit pretendohet të burojë pikërisht nga këto troje nderi dhe krenarie, si dashnorë të denja të lirisë, ndryshe dashnore të vërteta të jetës.

Kadri Ujkaj
Blinisht, më 10 qershor 2017

◀ nave të tjera, si të Pultit, të Mirditës e të tjerë nuk ju nënshtuan pushtuesit. Dhe kjo do të thotë, nuk ju nënshtuan, se jo nuk u pushtuan, të cilin nocion jo në pak raste e dëgjojmë dhe e lexojmë. Nuk mund të pranojmë, se këto krahina malore shqiptare nuk mundi ti pushtonte, pushtuesi osmani, por duhet të pranojmë, se ato nuk ju nënshtuan pushtuesit osman. Kjo është e vërteta dhe vetëm kjo e vërtetë duhet pranuar.

Gjithashtu, Fazliu na thekson se etimologjia e fjalës "Kelmendi" nga vjen! Dhe kjo fjale vjen nga latinishtja, që do të thotë "Clemens / tis, që shqip do të thotë "i urtë", "i thjeshtë", "i mirë". Është e vërtetë, se banoret e kësaj krahine, të krahinës së Kelmendit kanë qenë dhe janë të tilla. Kanë qenë dhe janë njerëz bujar, njerëz të thjeshtë, njerëz të mirë, njerëz fjalë pak, njerëz të urtë, njerëz trima, janë atdhetar të flaktë.

Ka jo pak mendime, se Papët me ketë emër, me emrin Kelmendi, si Papa Klementi i Parë, në vitet 90 – 101 apo Papa Klementi XI, në vitet 1700 – 1721, janë nga kjo krahinë dhe prandaj kanë marre emrin Kelmendi! Në fakt, e vërteta është krejt ndryshe. Ata nuk janë nga kjo krahinë. Me këtë përcaktim, Fazliu largohet nga një folklorizëm, që jo në pak raste po na dëmton. Ne duke marre e bërë të tonat vlera që nuk na takojnë, shpesh

kemi bere përpjekje që të hipim në "qiel", dhe ne duke e quajtur veten qiellor, nuk është marre kush me ne, se ne kemi harruar, që njerëzit ecin për tokë dhe në qiell mund të shkoj shpirti i tyre, kur të shkojnë te të shumtit.

Pra, fshati Kushtani apo hapësira e Kushtanit i banuar nga këta banorë, nga këta që ishin bujare, ishin të urtë, ishin njerëz të mire, por jo të nënshtuar ndaj së keqes, ndaj pushtuesit, dhe nuk do të dilte ndryshe, që pasardhësit e tyre, kushtanët që të mos ishin aq bujare, aq të urtë, aq të mirë dhe aq heroik në luftërat për liri e të pa ndalura me armiqtë, me otomanet, me sllavet e deri me nazistet e fashistet, deri në çlirimin e tyre, me 12 qershor 1999.

Fazliu, është nder të radhët, që na paraqet prejardhjen e banoreve të këtij fshati e të gjithë Rugovës. Ata rrjedhin nga Nika. Nika u bë me katër djem, Dreli, Staka, Pepa dhe Nili (rasti i radhe që kemi të bëjmë me katër vëllezër, se në të shumtët e rasteve kemi tre vëllezër dhe madje njeri edhe qeros ...). Deri në katër brez, rreth një shekull, këta i qëndruan me heroizëm trysnisë otomane për të mos u islamizuar. Pse e theksoj këtë, se në disa monografi gjejmë lidhjen me të parët e tyre, deri aty ku është kthyer i pari i tyre në besimin islam. Unë nuk e di arsyen, sepse gjate një studimi për fisin Gjuraj, në disa vende, si në Burrel, në Peshkopi,

në Bulqizë, në Librazhd, në Tetovë, në Suharekë, në Radac të Pejës, në Shishman e Gerçar të Gjakovës, nuk e çojnë dot lidhjet e tyre në breza, vetëm deri në 6 – 7 breza, ku i pari i tyre është kthyer në besimin islam, çka nuk e konsideroj të drejtë, dhe ndryshe më ka ndodhur në Strellc të Deçanit, në Gjuraj të Koplikut të Sipërm. Kjo pune e zotëri Fazlise, është për tu admiruar.

I lumtë!

Fazliu, më së miri na paraqet luftën e gjatë, luftën e madhe, luftën pa kompromis, me çdo çmim që është bere, me çdo pushtues nga banoret e këtij fshati apo te të gjithë trevës së Rugovës, sa të shkon në mendje, se si është e mundur të kemi banorë të gjallë, sot në këto hapësira, që aq shumë kane mbetur në fushën e betejës, që aq shume janë vranë, janë përndjekur, janë persekutuar. Por këta rugovas e kushtinas kane ditur me heroizëm të pa imagjinueshëm të mbijetojnë dhe në fund të fundit të dalin fitimtar.

Fazliu, me përkushtim na paraqet dashurinë e këtyre banoreve për dituri, për dije, për mësim, për shkolle, që sot ka qindra e mija profesor, artist, shkrimtar, poet, historian, shkencëtar e deri akademik të nderuar, që nder ta ishte i madhi Ibrahim Rugova.

Fazliu, më emocion, me punën e tij të palodhur që ka bere duke evidentuar e paraqite në këto dy libra heroizmin e

të pareve nëpërmjet këngëve, që atyre ju ka kushtuar populli. Është një pune jashtëzakonisht e vyer, në veçanti për edukimin e brezave të sotëm e të brezave të ardhshëm.

Gjithashtu, Fazliu na paraqet me një përkushtim të jashtëzakonshëm të banoreve të sotëm të kësaj treve, të fshatit Kushtani e të gjithë Rugovës, respektin e mirënjohjen që kane për të parët e tyre, për mbijetesën e tyre, për sakrificat e tyre, për gjakun e tyre e të tjera e të tjera, duke i nderuar, duke ju ngritur lapidare, monumente, memorialë dhe duke i nderuar me mbi të gjitha me mirënjohjen. Kjo që paraqitet në këto dy libra, është një edukim i madh, që ju trashëgohet brezave për respektimin e të pareve të tyre.

Të lumtë!

Të lumtë i nderuar Fazli, se ke bere një punë shumë të madhe, një pune shume atdhetare për edukimin e brezave me atdhedashurinë!

Më lejoni ta mbyll këtë opinion të shkurtër për këto dy vepra të zotërisë Fazlise, duke i uruar jetë të gjatë, punë të reja studimore e historike, dhe të na bashkosh përsëri me vepra të tjera në shërbim të kombit, në Shkodrën tonë.

Faleminderit!

Ndue Sanaj,
Shkodër, më 27 maj 2017


Po me fortifikimin ç' patën?

Me datën 25 maj 2017, në mjedisin e Bar – Restorant “BLINI”, u organizua ceremonia e paraqitjes së librit, me titull “Me fortifikim ç' patën”, me autor kolonel Hysen Qëndro, në pension.

Ketë ceremoni, e drejtoi me mjaft kompetence major Gjon Bruçi, në pension. Pasi beri hapjen, së pari foli kolonel Ndue Sanaj, në pension. Pastaj dhanë opinionin e tyre Bajram Mane, ish Z/Ministër i Mbrojtjes; kolonel Nevruz Sako, në pension, ish Komisari i Shkollës

Kampeve Ushtarake, nga më të fuqishmet të kohës, të atij të NATO-s dhe të atij të Traktatit të Varshavës. Pra, në mes Lindjes – Kampit Socialist dhe Perëndimit – Kampit Kapitalist.

Megjithatë, Kolonel Hyseni, jo vetëm që paraqet me anë të këtij libri atë punë të madhe, të jashtëzakonshme, por dhe problematikat e kohës, të cilat me pak kujdes do të ishin evituar. Gjithashtu, gjithë ajo punë kolosale, pavarësisht nga shkatërrimi absurd, që i është bërë asaj,



se Oficereve; Kujtim Çako, ish Z/Ministër i Mbrojtjes dhe sot Presidenti i Shoqatës “Aleanca Kombëtare e Ushtarakeve të Shqipërisë (AKUSH)”; kolonel Ismail Shulku, në pension, ish Nd/Shefi i Shtabit të Përgjithshëm dhe Komandanti i Frontit të Veriut, dhe në fund kolonel Vuksan Vukaj, në pension, ish komandant i Brigadës së Artilerisë në Shkodër dhe tani kryetari i AKUSH - dega Shkodër.

Të gjithë këta shprehen mendime vlerësuese për punën e Kolonel Hysenit. Fortifikimi i vendit ka qenë një ndërmarrje e madhe, me kosto të jashtëzakonshme për ekonominë e vendit dhe për mirëqenien e popullatës, por i domosdoshëm për mbrojtjen e vendit në konceptin e Luftës Popullore dhe për periudhën e Luftës së Ftohte në mes dy

ajo që ka mbetur duhet regjistruar dhe duhet të merret në ruajtje, si një vlerë e madhe për mbrojtjen e vendit.

Në fund, Presidenti i Shoqatës “Aleanca Kombëtare e Ushtarakeve të Shqipërisë”, zoti Kujtim Çako, Kolonel Hysen Qendrës i jep titullin “Krenaria e Aleancës kombëtare të Ushtarakeve të Shqipërisë”, për kontributin që ka dhënë në jetën e tij ushtarake dhe në pension, në shërbim të vendit.

Në mbyllje të kësaj ceremonie, autori i librit, kolonel Hysen Qëndro, për pjesëmarrësi shtroi një koktej të mire, ndërsa me një pjese prej tyre, në Shiroke shtroj një dreke, e cila kaloi shume e gëzueshme ...

Korrespondenti i "Dukagjinit"

Kolonel Hysen Qëndro, një kuadër i rëndësishëm në jetën e ushtrisë sonë

Me shume respekt, kolonel Qëndro më dërgon librin, me titull “Mehmet Shehu – reformator i Ushtrisë Popullore Shqiptare” dhe pas pak kohe edhe librin, me titull “Po me fortifikimin ç' patën”. Te dyja i kam lexuar me vëmendje, sepse në te dyja më ka tërhequr një diçka e veçante e autorit: Ndjenja e larte që ka Kolonel Hyseni për atë që shkruan. Atë e shkruan me shumë pasion, pa inate, pa urrejtje, por ashtu siç e ndjen problemin, kujtimin, historinë, mundin e djersën e njerëzve.

Kolonel Qëndro ka qenë një nder ushtarake të karrierës me emër në jetën e Forcave të Armatosura të Republikës Socialiste Shqiptare, i cili, si shumica e ushtarakeve të karrierës, ka punuar me shumë përkushtim, me kuraja dhe ketë cilësi e tregon edhe në ketë libër, për të cilin jemi mbledhur. Këto cilësi i

ka reflektuar edhe kur ishte në detyrën e Komandantit të Brigadës së Këmbësorisë në zonën e Bushatit, në Shkodër.

Në ketë libër pasqyrohet dhe jeta ime, jeta e kolegëve të mi, jeta e vartësve dhe të eproreve të mi, jeta e ushtarëve e nënoficerëve, të punonjësve, jeta e gjithë popullit ushtar në ketë ndërmarrje të jashtëzakonshme. E jashtëzakonshme për nga përmasat, për nga mundësia ekonomike, për nga popullsia dhe për nga koha në dispozicion. Në ketë ndërmarrje kaq të madhe, të këtyre përmasave vetëm një popull i përfshire në nocioni “Populli ushtar” mund ta realizonte.

Kolonel Qëndro e paraqet me vërtetësi atë punë aq të madhe që u bë. Por, kolonel Qëndro na parqet më me shumë forcë dhe me indinjatë të thellë denigrimin që i është bërë dhe vijon ti bëhet kësaj pune kaq të madhe, kaq të domosdoshëm për luftë, për mbrojtjen e vendit, si elementi i trete i luftës, dhe i domosdoshëm. Kjo është e veçanta e këtij libri. Hyseni nuk ka pas ndërmend, nëpërmjet këtij libri ti bëj analizë fortifikimit, por paraqet dhe i bën analize qëndrimit absurd, që është mbajtur e vijon ti bëhet fortifikimit.

Më lejoni t'iu tregoj dy episode të shkurtra:

Së pari, në vitin 1992, në muajin maj, ishte një gjendje e rënde me fqinjët, me Jugosllavët ..., e vërtetë apo artificial, ketë nuk jam në gjendje ta përcaktoj, por në fakt ne, ishim në gjendje të gatishmërisë nr. 1. Në këto kushte, erdhi në Komandë të Divizionit, Kryetari i Komitetit pluralist të rrethit Shkodër, i cili pasi dëgjoi informimin që i beri Kolonel Enver Gaba, në atë kohë komandanti i Divizionit, shfaqti dëshirën të bëj një inspektim kufirit. Komandanti i Divizionit, më caktoi

mua të shoqëroi Kryetarin. Me kryetarin dolëm në përnjohjen e terrenit duke pare gjithë vijën e kufirit, rajonet e mbrojtjes së postave kufitare, dhe madje duke hyre në çdo qendër zjarri, që nga rajoni Pulaj të Velipojës e deri në rajonin Hani i Hotit ... Nga fundi i kësaj përnjohje, i këtij kontroll, Kryetari më pyeti: Zoti Shef, a mund ti bëjmë balle ndonjë agresioni të mundshëm? I thashë po, se barut kemi,



qendra zjarri kemi, siç i pe vete, por nuk e di, se sa kemi zemër, se sa na ka mbete ... dje kishim zemër, sot nuk e di ... Ai heshti ... Pra, ai që nuk linte gjë pa thënë për fortifikimin, u fut qendër me qendër zjarri, duke pare frëngjinë, pastërtinë e tyre dhe duke ju dhëne porosi ushtarëve e oficerëve, që të jene gati në rast nevojë. “Këto qendra zjarri janë shtëpia e jonë në rast lufte, për të mbrojtur vendin

tonë të shtrenjtë, prandaj ti mbani pastër e ti maskoni sa të jete e mundur, në ofte se mundet, edhe të mbjellët bare e pemë rreth tyre, me qellim që të duket vendi sa më origjinal me mjedisin, me kusht pa bllokuar pamjen e qitjes ...”, Kryetari, këto porosi ju dha efektive të kufirit në çdo postë.

Së dyti, në muajin gusht të vitit 2001, isha në rajonin Gargano të Italisë, në vendin e quajtur San Menaio, në Plazhe dhe aty ishte një gjeneral, gjeneral Giuseppe Malcini, në pension, rreth të 75 viteve. Pasi u njoha me te dhe ai më njohu mua, që isha nga Shqipëria. Po sa u njoh me mua dhe se isha nga Shqipëria, me tha: “Albania bunkerizëm ...!” Më habiti reagi mi i tij ..., por e mora veten. Ju drejtova dhe i thashë: “Zoti gjeneral, çfarë detyre keni pasur para se të dilnit në pension? Ai, me tha: “Kam qenë komandant Divizionit!” Ah sa mirë, i thashë, paske qenë komandues, që i njeh mirë të tre elementët e luftimit!? Unë kam qene në detyrën komandant Brigade dhe më vone, kam qene zëvendësi i juaj, në detyrën e Shefit të Shtabit Divizioni, me gradën kolonel ... Më vjen keq zoti gjeneral, që e ka haruar elementin e trete të luftimit ...”. Më shikoi me shume vëmendje, me një fare qortimi, ashtu siç shikon eprori vartësin, kur nuk i pëlqen vërejtja që i bëhet prej tij ..., por megjithatë: “U ngrit në këmbë ...” Po sa, ai u ngrit në këmbë dhe unë, instinktivisht u ngrita në këmbë ... Ai, megjithëse ishte i shkurtër, “ngriti kra-hun dhe me pëllëmbë, më ra shpatullave .. keni të drejte zoti kolonel ..., më fal ...!”

Me këto dy shembuj dua të them, se duke e shikuar politikisht, me urrejtje regjimin që u kalua, fortifikimi që kemi bërë në atë kohë zhvleftësohet dhe shi-

KOMUNITETI KATOLIK SHQIPTARË NË BELGJIKË ORGANIZON NJË DARKË PËR GRUMBULLIMIN E FONDEVE PËR SHTATOREN E SHËN TEREZËS

Pas një emigrimi rreth 60-vjecarë në Belgjikë të komunitetit katolike shqiptarë, arrijnë të organizohen për herë të parë në një darkë të përbashkët me 20 maj 2017, ku janë të pranishëm tre brezni emigrantësh të ardhur në periudha të ndryshme. Është padiskutim një meritë e iniciatorit Kin Kukaj i cili përfaqëson një nder familjet me të mëdha të emigruar në Belgjikë, ardhur nga fshati Rajë, i zonës Nikaj-Mërturit, Tropojë. Në fillim të pranishmit i ka përshëndetur At Gery Ëalsh misionar Kanades i cili shërben në famullin e Londrës, por falë misionit në Kosovë dhe Shqipëri celebron meshën në gjuhën shqipe në kishën Shën Anges në Laeken Bruksel. Ka përshëndetur komunitetin shqiptarë për iniciativën e marrur për ndërtimin e një kapele lutjeje të Shëjtes Tereza. Ai theksoj rëndësin e madhe që luan komuniteti shqiptarë në Belgjikë, që krahas komuniteteve të vendeve të ndryshme të botës edhe komuniteti shqiptar një herë në muaj të marrë pjesë në meshën e shejtë tashma e njohur zyrtarisht nga ipeshkvia Bruksel-Meline. Marie Pjetri koordinatorë për meshën e shejtë në gjuhën shqipe dhe Arber Nol Stani përfaqësues i rinisë katolike në Bruksel kanë falënderuar pjesëmarrësit për prezencën e tyre në grumbullimin e fondeve si dhe mundësitë e krijuar nga Shpend Vat Sokoli i cili përfaqëson shoqatën Eaglevent.be

për sponsorizimin e kesaj mbramje. Në këtë mbramje ishin të ftuar edhe komunitete të bashkësive të kombeve të tjera. Sipas organizatoreve Fran Sokoli, Marie Pjetri dhe Arber Stani kanë informuar pjesëmarrësit me punën e filluar që me 17 prill 2017 në ngritjen e kapelës ku do të lartësohet Shejti Tereza në vendin ku është shfaqur Zoja e Bekuar nga 15 janari deri me 3 mars 1933, në Banneux, provinca e Liezhes 40 km larg Brukselit. Në këtë atmosferë festive të pranishmit i ka përshëndetur Kryetari i Komunitetit Katolike Shqiptar në Belgjikë Kin Kukaj i cili nënvizoj rëndësinë e unitetit të këtij komuniteti të cilët të gjithë së bashku mund të ecim përpara duke bërë vepra të mëdha. Njohja me njeri-tjetrin është tepër e rëndësishme në shfrytëzimin e potencialeve intelektuale të rinisë si dhe sukseset e arritura në integrimin në shtetin Belg. Me ngritjen e shtatores së Shën Terezës në Banneux, beimtareet do të kenë dhe një kapelë krahas Zojës Bekuar ose siç njihet në Belgjikë, Zoja e te Varfërve, të luten për Shejtëreshën Shqiptare tashma shumë famoze në tërë botën. Kjo është dhe një nder për të gjithë shqiptarët dhe një pasaportë njohjeje për komunitetin shqiptar. Tepër festive këtë darkë e bënë këngëtarët e njohur Fran Piniqi e Gofile Papeleka të cilët intepertuan këngë shqiptare si dhe meloditë me çifteli e Mark



Cumit ku nuk munguan këngë e valle nga gjitha trevat shqiptare. Gjatë kësaj darke sipas deklarimit të Arbër Stanit, i cili përfaqëson rininë shqiptare katolike në Bruksel, janë mbledhur 4300 euro, që do të

shkojnë për ngritjen e shtatores së Shën Terezës.

Zef Nika
Bruksel, maj 2017

kohet me atë sy, që gjenerali italian mu drejtua në fillim. Por, kur shikohet me syrin e specialistit, me syrin e ushtarakut të karrierës, me syrin e ushtarakut komandues, sigurisht do të flasësh ndryshe, por gjithnjë pasi problemin ja ke dërguar arsyen.

Dua të ndalem te një shqetësim dhe merak i kolonel Qëndro Ai, në faqen 98 ... shkruan: "... Ministria e Kulturës e rinisë ... është mirë që të ketë informacionin e nevojshëm për gjendjen e fortifikimit që është kryer në vendin tonë, duke e pare në këndvështrimin e saj ...".

Sigurisht, mendimi, shqetësimi i kolonel Qëndros, është i drejtë, se ai mund aq i madh i joni dhe i popullit ushtar, gjithë ajo ngrehine po humbet, po shkon dëm, po shkatërrohet. Shqetësimi dhe mendimi, që ky fortifikim të kthehet në monument kulture dhe të jete në vartësi të Ministrisë së Kulturës, mire do të jete, por mendoj se është një ndërmarrje e madhe dhe e vështirë që të administrohet nga kjo Ministri, sepse mendoj, se ajo nuk është as në inventar të Ministrisë së Mbrojtjes, as të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura Shqiptare. Dhe, kur nuk është në inventar të kësaj Ministrie e të këtij Shtabi, si mund të jete në inventar të një ministrie tjetër?! Pra, në fillim duhet të marri përgjegjësinë Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm, të cilat në radhe të pare, të përcaktojnë, se në cilat rajone fortifikimi duhet të kthe-

het në monument kulture dhe të ruhet. Pse e theksoj këtë? E theksoj, se fortifikimit fizikisht i është bërë një shkatërrim i jashtëzakonshëm. Në raport me këtë duhet të dalin vendime, ligji për marrjen e tyre në ruajtjen, në të cilin të përcaktohen dhe pasojat ndaj atij apo atyre që do të shkatërrojnë më tej. Pra, për të zbatuar këtë ide, mendoj që në baze të bashkive, në baze të Njësisë Administrative të përcaktohen, se cilat objekte të fortifikimit mund të jenë monument kulture, dhe nesër objekte luftarake, sepse ato janë të një niveli kështjelle. Por, në këto struktura vendore duhet të ketë objekte të tilla, ashtu siç duhet të ketë dhe në nivel kombëtar dhe të gjitha këto të varen nga Ministria e Kulturës dhe Ministrisë së Mbrojtjes. Por, në plan të pare duhet të dali Ministria e Mbrojtjes. Ashtu, që mendoj, se një kritike e madhe duhet t'i shkoje Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, sepse ato duhet të jene mbrojtësit e saj, dhe deri tani nuk kam dëgjuar asnjë Shef Shtabi të Përgjithshëm të flas për këto objekte mjaft të rëndësishme të mbrojtjes sonë. Ju, kolonel Qëndro jeni i pari, që ngrini zërin në mbrojtje të kësaj pasurie kombëtare, me përmasa kaq të mëdha.

Të lumtë!

Gjithashtu dua të ndalem edhe te një çështje tjetër. Kolonel Qëndro, në faqen 38 - 39 ... shkruan: "Duke shprehur vlerësimet për fortifikimet ushtarake, që

janë kryer në vendin tonë, nuk e përgjosh faktin që në gjithë atë vepër të madhe, ka edhe pasaktësi, teprime e mangësi ...

Jam me ty zoti kolonel, se në planifikimin e tyre ka pasur teprime dhe në procesin e zbatimit të tyre ka pasur patjetër gabime deri dhe të renda, trashanike.

Mendoj, se specialistët dhe në veçanti përgjegjësit e përgatitjes së hapësirës së Teatrit të Veprimeve Luftarake, të Teatrit të Luftës, të terrenit në pikëpamje xheniero - luftarake, duhet të dalin para popullit dhe së pakut të kërkojnë falje, se jo çdo gjë ishte e udhëheqjes, ishte edhe e specialistëve. Dhe këta nuk duhet të fshehën pas shpinës së udhëheqjes të asaj kohe.

Ka shumë vend për të kërkuar falje!

Së pari, humbjet në bregdet, që janë të jashtëzakonshme! Pse u bë fortifikimi pa e studiuar në pikëpamje gjeologjike?

Së dyti, në rajonet alpine, të gjitha qendrat e zjarrit i shkatërroi ngrica, akulli, se sasia e çimentos e caktuar për montimin apo lidhjen e elementeve në formë portokalli, nuk ishte në sasinë e nevojshme, që ti rezistonte akullit dhe me gjithë sugjerimet nuk e bën ndryshim e duhur.

Së treti, u rend pas sasisë, në kurrizet të cilësisë, duke e quajtur zbatimin e planit të fortifikimit, barometrin kryesor në gatishmëri dhe në njësi. Për rrjedhojë, jo në pak raste u vendosën qendrat e zjarrit jo në rajonet apo pozicionet e planifikuar. Vetëm në rajonin e Zgjeçit, në

Has, në një pozicion zjarri skuadre ishin vendosur 57 qendra zjarri, nga 5 cope që kërkonte plani dhe nevoja, sepse aty shkonte vinçi, ndërsa në rajonet e tjera duheshin çuar elementet me krah. Kështu, kudo ka pasur gabime të tilla të renda. Edhe në Zonën e Mbrojtjes së Korpusit apo më vonë të Divizionit të Shkodrës.

E mbyll: ashtu siç e thekson kolonel Qëndro, edhe unë, e kam për nder dhe krenari që kam qenë pjesëtar i Ushtisë Popullore Shqiptare. I asaj ushtrie, që për asnjë çast dhe për asnjë arsye, nuk lëvizti aspak nga kryerja e detyrave të saj, në shërbim të popullit dhe në mbrojtje të Shqipërisë. Në pikëpamje profesionale ushtarake, ne, kuadrot e asaj ushtrie e quajmë veten me fat, që punuam për organizimin, stërvitjen, përgatitjen dhe drejtimin e njësisë të mëdha ushtarake gjitharmëshe. Asnjë here më pare, Shqipëria nuk ka pasur një numër aq të madh forcash dhe mjetesh nën armë, në mbrojtje të saj ...

Të lumtë kolonel Qëndro ...!

Edhe një here të lumtë koleg e miku im, kolonel Hysen Qëndro, mendja e dora dhe me këto që ke shkruar e do të shkruash mbete i gjallë, i pavdekshëm.

Mirënjohje për punën që ke bërë!

**Ndue Sanaj, kolonel në pension,
Shkodër, me 25 maj 2017**

GENTIANA LUTEA

(Bari i zemrës)

E njohin si bar zemre, sanëz, kërrsanëxë, sancë, ksane, raven, lincurë - por emrin e ka Gentiana. Bëhet fjalë për një barishte të hidhur që vjen nga bima e verdhë me emrin botanik *Gentiana lutea*. Vendlindja e kësaj bime është në Evropën Jugore. Ajo gjendet në malet shtatlartë të Shqipërisë dhe në shpate që ngrihen mbi 1000 metra lartësi.

Emri i kësaj bime vjen nga Mbreti i Ilirisë, Genti, vendi i të cilit është djepi i shqipeve. Ilirët ishin të parët që përdorën këtë bimë për të ulur temperaturën dhe për të shëruar një sërë problemesh shëndetësore.

Rrënjët e *Gentianës* mblidhen në pranverë ose në vjeshtë nga bimët mbi dy vjeçare.

Specialistët e tregojnë se kurat mjekësore kanë nevojë për rrënjë të thara nga dielli ose të ruajtura në vende të thata. Rrënjët e *Gentianës* janë të mbrojtura me ligj në shumë vende të botës, ku ndalohet tërësisht mbledhja e tyre në natyrë. Megjithatë në Shqipëri,

këto bimë të egra janë lehtësisht të këputshme nga njeriu. Siç e thamë edhe më lart, *Gentiana* e ka origjinën në Ilirinë e lashtë. Kjo bimë shqiptare ka gjetur rrugën e saj në mbarë botën, madje ka çelur deri në Kinë që tashmë është kthyer në prodhuesin më të madh të kësaj bime në rang botëror. *Krenaria* shqiptare përdoret në shumë mënyra.

Më origjinalet vërehen në veri të vendit që gjeografikisht është vendi i lindjes së *Gentianës*. Në Koplik dhe Kelmend, rrënjët e kësaj bime shiten për 300 lek/kilogram. Fermerët vendas arrijnë të mbledhin qindra kilogramë rrënjë në vit. Përdorimi më popullor i bimës është si përbërës aktiv i rakisë së sanzës, një pije tradicionale e Koplikut të Shkodrës që kushton 600 lek/

litri.

Gentiana gjendet edhe në Theth, Bogë, në Malësitë Mbi Shkodër, në Vuthaj dhe Guci, në toka malore naturalisht organike. *Gentiana* apo sanza përbën një aktivitet të konsiderueshëm për banorët e zonave malore, të cilët më pas e dorëzojnë në firmat që merren me eksportimin e bimëve



medicinale në tregjet ndërkombëtare. Rrok Bunjaj është një nga më të pasionuarit pas sanzës dhe tregon për se e ka kthyer punishten e tij në Tamarë të Kelmendit në një bazë të vogël prodhimi artizanal ku recetat më special përmbajnë *Gentianën* e maleve përreth. 'Kjo bimë ka vlera jo vetëm historike, por edhe medicinale krejt të pazakonta dhe mjaft të fuqishme për organizmin', *Gentiana* është një element i rëndësishëm i prodhimit të pijeve të njohura si "bitter", madje në të shkuarën është përdorur edhe për prodhimin e birrës. Përbërësit e rrënjës së bimës kanë element hidhur të njohur si *gentianine*, *gentiamarinë* dhe *gentialutinë*, vajra esenciale si *carvacrol*, *limonene* dhe *linalool*. Për më tepër ato përmbajnë amino acide, minerale si

alumin, kalcium, krom, kobalt, hekur, magnez, mangan, fosfor, kalium, selenium dhe sodium. Rrënjët e *Gentianës* janë të pasura me pektinë, fibër, vitamina dhe proteina. Përdorimet e rrënjëve të *Gentianës* në mjekësi Sistemi tretës. *Gentiana* është një nga kurat më të mira për problemet me stomakun. Sipas kërkimeve elementët e hidhur të bimës shumëfishojnë prodhimin e lëngjeve tretëse dhe si rrjedhojë *Gentiana* promovon një oreks të mirë dhe ndihmon tretjen. Nëse keni një stomak të dobët, kjo bimë ju ndihmon me tretjen duke e përsheptuar procesin dhe parandaluar që vijnë si pasojë e mos tretjes. Zhyni 0.5% gram rrënjë *Gentiane* në ujë të ftohtë për katër orë. Çdo ditë, para çdo vakti, pini një filxhan me këtë ujë. Mungesa e oreksit. Kjo shkaktohet për arsye të ndryshme,

probleme personale, dobësi dhe anoreksi. Kjo simptomë zgjidhet nga konsumimi i pluhurit të rrënjëve të *Gentianës* së tretur në ujë të ftohtë për 4 deri në 5 orë. Këshillohet të tresni 15 gramë lule të thata me 15 gramë lëkurë portokalli në një litër verë të bardhë për 10 ditë. Filtojeni dhe pini nga një gotë përpara vakteve. Fryrjet. Teprica e gazit në stomak që trajtohet nga tretja jo e mirë mund të zgjidhet falë kësaj bime. Duhet të tresni 1.5 gramë pluhur të rrënjës së *Gentianës* në një gotë me ujë për katër orë. Një gjë të tillë duhet ta bëni për disa ditë me radhë. Mëlçia. *Gentiana* mund të përdoret për t'i ardhur në ndihmë mëlçisë dhe për të ndihmuar organizmin të funksione kur ky organ has në vështirësi. Përdorimi i kësaj bime parandalon verdhëzën,

akumulimin e lëngjeve, lodhjen etj. Tresni 0,2% rrënjë *Gentiana* në ujë për disa ditë. Ju duhet ta kulloni mirë dhe përziemi lëngun me 400 gramë mjaltë. Pini nga pak çdo ditë Krimbat intestinalë. Disa prej përbërësve të bimës e bëjnë atë fantastike për largimin e krimbave intestinalë. Tiroidet. *Gentiana* ka përbërës që ndihmojnë në prodhimin e hormoneve të tiroides. 0,2% e rrënjës së *Gentianës* duhet tretur në ujë për disa ditë. Kullojeni mirë dhe përziejeni lëngun me 400 gramë mjaltë. Pini nga pak çdo ditë. *Gentiana* është një bimë që pastron trupin, gjakun dhe parandalon infeksionet. Kur jeni të lodhur fizikisht, ose jeni duke marrë veten nga një sëmundje që ju ka marrë të gjitha energjitë, *Gentiana* është mikeshja juaj më e mirë. Toniku i kësaj bime rikthen forcën në mbarë trupin por ndihmon edhe tretjen. Sipas kërkimeve të eks bima përdoret si pastruese gjaku. Ajo largon toksinat dhe papastërtitë nga qarkullimi i gjakut. Mjafton gjysmë luge gjelle me rrënjë të thatë në një filxhan ujë për 10 minuta. Kullojeni mirë dhe konsumoni dy filxhanë në ditë. Përdorimet mjekësore të luleve të *Gentianës* Rënia e flokëve. Falë përmbajtjes së lartë të zinkut, *Gentiana* është pjesë e shumë shtesave për parandalimin e rënies së flokëve, por edhe të zbokthit. Psoriasis, *Gentiana* kuron sëmundjen që shoqërohet me të kruara. Mjaftojnë 20 gramë të rrënjëve të thata në një litër ujë për 15 minuta. Aplikoni lëngun sa është i ngrohtë në zonat e infektuara dhe do të mësoni si ta ruani Cilësinë e Miellit në Shtëpi

Ruajtja e miellit duket gjëja më e thjeshtë në botë. Në të vërtetë, është krejt e kundërta. Të gjitha llojet e miellit – ai shumëpërdorimësh, i grurit

Nëse ju pëlqejnë çajrat bimorë, atëherë zgjidhni farat e linit, të cilat kanë qenë pjesë e mjekësisë tradicionale për qindra vite me radhë.

Përgatitur nga
Lulash Brigja

MBI FISIN E GJURAJVE

Në janar të këtij viti miku im, Kryetari i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", zoti Ndue Sanaj më dhuroi botimin e fundit, që është një studim i mirëfillt nga bashkëautorët Ndue Sanaj, Arben Gjura dhe Vat Gjoni. Serioziteti i punës së autorëve të jep të drejtën të gjykos për një punë voluminoze për përgatitjen dhe nxjerrjen e fakteve të këtij fisi, si një ndër dyertë më të vjetra të Pultit dhe më andej. Studimi "Gjurajt" është shembullor persi i takon kërkimeve, shtrirjes teritoriale, hulumtimeve mbi perjardhjen e emrit, trashëguesit e sotëm, si dhe toponomia e krijuar nga ky emër.

Autorët i kanë kushtuar një rëndësi të veçantë Gjurajve të Italisë, ku janë edhe

sot gjurmët e këtij fisi e mbi të gjitha për pozitën shoqërore e politike që kanë mbajtur si një familje fisnikësh bujarë në vendin e emigrimit. Pozita e tyre del qartë sidomos në kohën e Giuseppe Garibaldit duke arritë shkallët më të larta të hierarkisë politike e shoqërore. Është shkruar e thenë mjaft për këtë punim nga lexues, specialistë dhe analistë të kësaj fushe dhe në vijim të studimit mbi këtë fis, më bëri përshtypje dhe të ndalohem të një vëllim poetik shkruar nga një pinjoll i derës nobile të gjurajve, i quajtur Domenico Gjura (Domenico di Giura (1804 - 1882), të cilin e ka publikuar i mirënjohuri Ernest Koliqi të revista "Shejzat" e vitit 1964, nr 11 - 12, fq. 505, shoqëruar me një ekspozitë të shkurtër në italisht.

Koliqi thotë se këtë libër me poezi ma sollti në redaksi kusheriri i autorit, baroni Giovanni di Giura. Libri është shkruar shumë shpejt, por pa dritën e botimit pas vdekjes së autorit (1955), shkruar në italisht dhe vetëm në treqind kopje nga

Tipografia del Senato del Dott. Bardi. Në shkrimin shoqërore, Koliqi i bën një analizë këtij fisi si ma antikët e Shqipërisë dhe janë ndodhë kryesisht në Shkodër dhe rreth këtij qyteti, se gjurmët e tyre vinë deri në ditët e sotme dhe merr si shembull Arqipeshkvin e Durrësit mons. Pietro Gjura, i cili kishte qenë prift në Shkodër (vdekur me 1940). Ashtu si bashkëautorët e volumit "Gjurajt", edhe Koliqi flet për pjesëmarrjen e tyre si gjithë shqiptarë - italianët në rilindjen e Italisë. "Ata thotë Koliqi - dhanë të gjitha forcat mendore e fizike për atdheun e tyre të dytë, Italinë, duke treguar kështu aftësitë dhe genin e sjellur nga vendi i tyre i okupuar". "Psenë" e gjithë kësaj trimërie e sakrifice për dheun e tjetrit, Koliqi e spjegon në pak rrjeshta: "Pse, ndoshta, shembulli civil i të qenurit ajka e qyteterimit në token e lindjes, moren me vete kujtimet, dhëmbshurinë dhe dashurinë për liri të humbura në Mbreterinë e Shqipërisë".

Domenico, 1804 - 1882, Umaniste,

poeta, patriot, Sacerdote, Docent di lettere nel Liceo di Ptenza, fu Preside del Liceo "Cirilo" in Napoli. (Në bazë të dhënave, lindur me 1804 e vdekur me 1882. Ishte humanist, poet e patriot. Prift dhe docent në letërsi në Liceon e Potencës. Ishte edhe President i liceut "Cirillo", në Napoli.)

Po japim një fragment të vogël nga poezia e poetit Domenico Gjura me titull: "NJË VELË, NJË VELË." (për kujtim të dheut të origjinës). "... paqe o vend trimash, qiell që mbete pa vlerën e shpërbërimit. Perjetesisht ruan lirinë në kraheror; një liri me qetësi të shurdhët. Gara e bijëve tu kishte dhimbje e plagë e eshtrat tuaja nuk kanë as një vazo me hi të ruajtur për mëshirë. Por Qielli dhe Toka sado e lagur, nuk i shuan heronjt!"

Përgatite nga Ndoc Selimi,
Milano, qeshor 2017

Shkodra përzgjidhet mes 120 vendeve si "Udha e paqes"

Në Shkodër, të rinjtë e nismës për paqen universale pedalojnë në rrugët e qytetit, ndërsa nisma ndërgjegjësuese u përmyll me një koncert. Shkodra u përzgjedh nga organizatorët së bashku me 120 qytete të tjera për të dhënë mesazhin e paqes dhe të harmonisë në botë. Shkodra ka qenë qyteti i përzgjedhur në Shqipëri, mes 120 vendeve në të gjithë botën për nismën federatës së paqes universale, Udha e Paqes. Gjithçka nisi me pedalimin me biçikletë të të rinjve dhe u pasua me një koncert festiv në sheshin përpara Bashkisë pasdrekën e së mërkurës ku u përcollën mesazhe bashkimi e paqeje. Shqipëria është një shembull i mirë që ka çfarë t'i tregojë botës thanë organizatorët. Jack Corley: "Këtu jemi mbledhur në emër të paqes. Udha e paqes është pjesë e një projekti mbarëbotëror, ku njerëzit të mund të jetojnë në harmoni dhe paqe. Megjithatë kemi rraca e kultura, e kombësi të ndryshme është e rëndësishme të kuptojmë se ndajmë të njëjtin planet, jemi pjesë e familjes njerëzore të krijuar prej Zotit. Pra fati ynë është të bëhemi një familje". E iniciuar si mënyrë për të nxitur bashkimin mes dy Koreve dhe për zhvillimin e marrëdhënieve diplomatike mes dy vendeve, ky projekt zhvillohet në një numër të vendeve të botës për të promovuar paqen dhe bashkëpunimin mes njerëzve dhe kombeve.

Gazeta "DITA", me datën 8 qeshor 2017



Vllaznia në futboll për femra kampione për herë të katërt radhazi

Vllaznia e Shkodrës është kampione e Shqipërisë në futboll për femra për herë të katërt radhazi. Një sukses ky padyshim i madh për klubin Vllaznia që ka për protagonist trajnerin Nikolin Leka dhe kolegët, zv/trajnerin Ilir Dibra, trajnerin e portjerëve Elis Legata, si dhe presidentin Lazer Matija, ai që në fakt është kryefjala e çdo suksesi që në themelimin e kësaj skuadre. Këto ishin ermat e drejtuesve, por që padyshim, meritën më të madhe të këtij suksesi e kanë vete vajzat futboliste të formacionit kuqeblu, ato që në këtë kampionat arriten shifra rekord. Në 18 javë kampionat Vllaznia ka regjistruar 18 fitore duke grumbulluar 54 pikë, si dhe me një golaverazh super pozitiv, 153 gola të shënuar dhe një i pësuar, shifra këto që përbëjnë rekord për një skuadër futbollit. Një titull ky që në fakt i mungon prej vitesh ekipit të meshkujve, por që shpresohet se sukseset e futbollisteve femra të ndikojnë në përmirësimin e rezultateve edhe të ekipit shkodran për meshkuj në mënyrë që Vllaznia e drejtuar nga Armando Cungu të rikthehet tek titujt e munguar.

Sfida e fundit e kampionatit

Realisht titulli kampion për Vllazninë është siguruar dy javë përpara përfundimit të kampionatit, pas asaj fitoreje 2 me 0 që futbollistet kuqeblu arriten ndaj rivales direkte, Apolonisë së Fierit. Por zyrtarisht, ai është dorëzuar menjëherë pas ndeshjes së fundit të kampionatit, atë të luajtur në javën e fundit të kampionatit në stadiumin "Loro Boriçi" të Shkodrës përballë ekipit tjetër shkodran, "The Door". Ndeshje kjo që me tre golat e kapitenes Uendi Muja dhe një të Ambra Gjergjit u mbyllë me fitoren e Vllaznisë me rezultatin 4 me 0. Ja dhe skeda zyrtare e kësaj ndeshje:

Vllaznia - The Door 4 - 0

(Shënues: Muja 5', 38', 51' dhe Gjergji në 12')

Vllaznia: Raxhimi, Gjini (Avullija 65'), Bajraktari, Jashari (Lipa 46'), Muja, Mus-

tafaj (Bibaj 58'), Gjergji (Piranaj 55'), Koldashi, Gruda (Kotarja 60'), Franja, Doçi, Trajner, Nikolin Leka

"The Door": Kurti, Blinishta, Gjura, Thaçe, Shuto, Shurdha, Armoku, Çarku, Dibra (Prendushi 68'), Hallulli, Piri Trajnere, Dafina Puka

Gjyqtarë: S. Tushaj, S. Zeka, E. Daku (Shkodër)

Ceremonia

Gjatë ceremonisë zyrtare të organizuar nga ana e Federatës Shqiptare të Futbollit ku asistonin edhe zyrtari i FSHF-së, Endri Hyka dhe antari i Komitetit Ekzekutiv i FSHF-së, Vasil Bici, futbollistet shkodrane dhe grupi drejtues kanë marrë një e nga një medaljet e kampionit, ndërkohë që e fundit në radhë ka qënë kapitenia e skuadrës Uendi Muja, e cila

qënë kapitenia e skuadrës, Uendi Muja, futbolliste e cila me tre golat e shënuar në përballjen e fundit ndaj "The Door" ka shkuar në kuoten e 58 golave, kuotë kjo e njëjtë me kolegen e skuadrës së saj, Megi Doçi duke qënë më të mirat e kampionatit.

Trajneri Leka dhe presidenti Matija

Protagonistët e skuadrës kampione, trajneri i skuadrës, Nikolin Leka dhe presidenti Lazer Matija, i pari në drejtimin teknik të ekipit dhe i dyti në mbështetjen e pakursyer dhe të vazhdueshme financiare, janë dy persona që kanë kontribuar shumë për arritjen e këtij suksesi. Mbas kurorëzimit si kampione për herë të katër të skuadrës kuqeblu, ato shprehen të gëzuar dhe të lumtur që vazhdojnë të mbajnë kurorën e kampiones së Shqipërisë

ato menjëherë duke nisur që nga java e ardhshme do të jenë pjesë një turneu të rëndësishëm ballkanik në futboll për femra që do të zhvillohet në Greqi. Një veprimtari, kjo që krahas të tjerave është edhe një kolaudim më shumë për pjesëmarrjen që Vllaznia do të jetë në muajt e ardhshëm për kompeticionin e Liges së kampioneve të Evropës në futboll për femra, në të cilën Vllaznia merr pjesë për të katërtën herë radhazi.

Kapitenia Muja dhe portjerja Raxhimi

Me shumë emocion është pritur fitimi i këtij titulli edhe për sulmuesen Uendi Muja që me tripleten në ndeshjen e djeshme ndaj "The Door" ka shkuar në kuoten e 58 golave në këtë kampionat, njëri më i bukur se tjetri duke u barazuar me kolegen e skuadrës Megi Doçi, edhe ajo me po kaq gola të shënuar. Muja, që ka privilegjin të mbajë në krah shiritin e kapitenes së skuadrës, brenda dy viteve është bërë pjesë e dy kombëtareve të Shqipërisë, asaj U - 19 dhe të të ekipit të parë që drejtohet nga trajneri Armir Grima. Po ashtu, edhe për portjeren Ardiola Raxhimi që është edhe futbollistja më e re në skuadrën shkodrane, merita e së cilës qëndron në faktin se rrjeta e portës së saj është prekur vetëm një herë në të gjitha ndeshjet e këtij sezoni futbollistik.

Bici, "tifoz" i Vllaznisë

Një fakt interesant ka të bëjë edhe me të deleguarin e FSHF-së, Vasil Bici, person ky që gjatë viteve të fundit ka qënë i pranishëm thuajse në të gjitha ceremonitë e dorëzimit të trofeve ndaj Vllaznisë. Si një ish trajner i Vllaznisë që e lidhin shumë kujtime të bukura me qytetin verior. Bici shprehet me të qeshur se "sa herë Vllaznia do të ketë suksese të tilla do të vijë me shumë kënaqësi në Shkodër për të dorëzuar trofe të tilla, ndërkohë që e kundërta do të ndodhë që në rast se shkodranet nuk do ta fitojnë titullin, atëherë nuk do të preferonte të ishte në ceremoni."

Gaspere Marku



Ekipi i Vllaznisë kampion i Shqipërisë për sezonin 2016-2017 - stadiumi "Loro Boriçi" i Shkodrës

krahas medaljes individuale si pjesëtare e ekipit kampion, ka marrë në dorëzim edhe trifeun e titullit kampion. Moment ky që është shoqëruar me një entuziasëm të ligjshëm, që në këtë rast, kupa ka kaluar në duart e seciles lojtare. Më pas ka ardhur radha edhe e përcjelljes së emocioneve të suksesit, ku e para ka

për katër vite radhazi, ndërkohë që në sajë të elementit cilësor që kanë në dispozicion dhe kontratave afatgjata që kënd të lidhura me sportistët e tyre, premtojnë se këtë pozicion do të vijojnë ta mbajnë edhe në sezonet e ardhshme. Sipas tyre, edhe pse kampionati përfundoi, për Vllazninë e Shkodrës nuk ka pushim, sepse

Thethi, një mrekulli natyrore

- Fotoreportazh -

Parku Kombëtar i Thethit mbetet pika kryesore e turizmit malor në veri të Shqipërisë, kryesisht i preferuar si guidë e aventurës me kalimin nga Qafa e Valbonës. Për të shkuar në fshatin Theth, që konsiderohet si perla e Alpeve, ju duhet të udhëtoni me makinë drejt qyteti verior të Shkodrës për 50 kilometra deri në fshatin Bogë, dhe pastaj do të merrni 20 kilometra të tjera rrugë të pashtuar dhe me raste të rrezikshme. Më poshtë do të shikoni disa pamje të mrekullueshme nga Thethi të realizuar nga Elvis Nabolli për BIRN. *Marrë nga gazeta "DITA" me datën 4 qershor 2017*



REDAKSIA

Kryeredaktor: Luigj Shyti

Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra, Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja

Mundësoi
Botimin:
NDUE FTONI

